



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:  
“Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”  
Universiteti “Barleti”**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Elda Tartari**

**Dr. Edra Fresku**

**Korrik/ 2024**

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Master Profesional në: “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër të MAS Nr 5699/1 Prot, Nr. 506, datë 06.09.2022.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikël i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike, 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 - 6 PAE / 0 PAK 2023-2024 - 8 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 - 4 studentë 2023-2024 - 13 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në shqyrtimin dhe analizën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit “Barleti”, si dhe në veprimtaritë e realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe Universiteti “Barleti”. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm. Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm i përket programit të studimit me kohë të plotë, të ciklit të dytë “Master Profesional”, i titulluar specifikisht “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Ky program administrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) që është në kompetencën e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS). Me UMASR, Nr. 213 datë 03.07.2020, Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" hapur me vendim Nr. 571, datë 12.08. 2005, riorganizohet në Universiteti "Barleti". Universiteti “Barleti” në përbërjen e tij ka 4 Fakultete.

- Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
- Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit;

Ky program studimi është hapur sipas Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me Nr. 506, datë 06.09.2022, si “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Ai përmban 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike / 4 semestra. Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe. Forma e studimit është me kohë të plotë. Në përfundim të programit të studimi lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Veprimtaria akademike për programin e studimit fillon në vitin akademik 2022-2023. Numri i studentëve të regjistruar gjatë dy viteve akademike ka qenë:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 4 studentë;
- Për vitin akademik 2023-2024 është 9 studentë;

Programi i studimit i ciklit të dytë “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” nuk ka kaluar më parë proces akreditimi. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, për programin e studimit të ciklit të dytë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti Barleti, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof. As. Dr. Elda Tartari dhe Dr. Edra Fresku dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoreja teknike e ASCAL, znj. Anilda Beqiraj. Vizitat në Universitetin “Barleti” u realizuan në datat 18 dhe 19 Mars 2024. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.

***Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:***

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhër i MASH nr. 81, datë 25.02.2013
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017
- Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, ASCAL

### **Aktivitetet kryesore të realizuara**

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambientet e brendshme të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Universitetin “Barleti”.

**Analiza e të dhënave parësore** është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Mësuesi në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

**Analiza e të dhënave dytësore** u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Drejtues të institucionit që mbulojnë programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;

- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Alumnit dhe Karrierës dhe Zyrës së Shërbimeve Studentore;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Kërkimit Shkencor;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Kurrikulave;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë;
- Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) dhe vizitës në bibliotekë;
- Takimi përmbyllës me Përgjegjësin e Departamentit.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizmi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe vëzhgimi i mjediseve mësimore në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit dhe Universitetit "Barleti". Mësuhtetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB, si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.

Më datë 02/07/2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 99/18 Prot. datë 02/07/2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Kolegji ktheu përgjigje përmes AMS, më datë 05/07/2024. dhe shkresë Nr prot 671 date 05.07.2024 Komente nuk ka, Drafti kalon ne Raport perfundimtar.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar evidentohet se Universiteti “Barleti” e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me interesat kombëtare. Në vizionin e tij Universiteti “Barleti” (UniBa) <i>ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme dhe në përputhje me European Qualification Framework dhe Kornizën Shqiptare të Profesioneve, të bazuara në kërkim e inovacion, si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimin, për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirë-formuar.</i> <sup>1</sup>  Programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është në përputhje dhe përshtatje me interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Ky program <i>synon një formim profesional, bashkëkohor në këtë fushë, si dhe ofron një përgatitje tërësore, profesionale për të gjitha profilet e mësuesisë lidhur me ofrimin e identitetit, trajtimit, mbështetjes dhe zhvillimit të fëmijëve-nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.</i> <sup>2</sup>  Ky program udhëhiqet nga nevoja, për të ofruar një formim cilësor për mësuesit e teknologjisë, TIK-ut dhe atyre, që plotësojnë kriteret ligjore.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti “Barleti” evidentohet se programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është në përputhje me misionin e institucioni që <i>të përgatisë studentë të një niveli të lartë, profesionistë novatorë,</i>

<sup>1</sup> <http://umb.edu.al/universiteti-umb-misioni-dhe-vizioni.html>, gjendet në RVB TIK, Universiteti “Barleti”. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq> Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>2</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p><i>krijues e sipërmarrës, të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm</i>". Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me Kornizën Shqiptare dhe atë Evropiane të Kualifikimeve, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimin, për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirëformuar<sup>3</sup>. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) ka si vizion <i>edukimin dhe sigurimin e krijimit të kompetencave të duhura profesionale te studentët, të shprehura me njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera me synim punësimin në tregun e punës dhe mbështetjen e të nxënës gjatë gjithë jetës</i>. DSHETP mbulon programe studimi që i përkasin ciklit të dytë "Master" në edukim.<sup>4</sup></p> <p>Programi i studimit MPMTIK është hartuar në përputhje me fushën e veprimtarisë dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.<sup>5</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se programi i studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" me dy vite akademike është i organizuar si program i ciklit të dytë "Master Profesional", në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 (neni 75) dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit "Barleti" dhe aktet e brendshme rregullatore të Universitetit "Barleti".<sup>6</sup> Ky program studimi është organizuar në 120 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në</p>	<p>Rezulton se programi Master Profesional në "Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" me dy vite akademike zhvillohet në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statutin e Universiteti "Barleti"<sup>7</sup>;</li> </ul>

<sup>3</sup> <http://umb.edu.al/universiteti-umb-misioni-dhe-vizioni.html>, gjendet në RVB TIK, Universiteti "Barleti". Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>4</sup> Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të Departamentit.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>5</sup> Evidenca 10, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq.4. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>6</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>7</sup> Statuti i Universitetit Barleti.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2030 të Universitetit “Barleti”<sup>8</sup>;</li> <li>- Strategjinë e zhvillimit të Departamentit për programet e ciklit të dytë<sup>9</sup>;</li> <li>- Rregulloren e Universitetit “Barleti”<sup>10</sup></li> <li>- Rregulloren e Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve<sup>11</sup>;</li> <li>- Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional<sup>12</sup></li> <li>- Rregulloren e programit të studimit MPMTIK<sup>13</sup></li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i Studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” i përgjigjet fushës së studimit të Universitetit “Barleti” dhe Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, si dhe është i hartuar në përshtatje dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Statutit dhe Rregullores së Universitetit “Barleti”.</i></p> <p><i>Departamenti që mbulon zhvillimin e programit të studimit ka përvojën, kapacitetet akademike, si edhe burimet e duhura për administrimin me sukses të gjithë programit.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr style="background-color: #cccccc;"> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<sup>8</sup> Evidenca 10, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq.4. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>9</sup> Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të Departamentit.pdf. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>10</sup> Rregullore e UniBa.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>11</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>12</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Departamenti të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP).pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>13</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se Universiteti "Barleti" është licensuar me VKM Nr. 571, datë 12.8.2005 për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, Universiteti "Marin Barleti" dhe me Urdhër të MASR, Nr. 213 datë 03.07.2020 Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti "Barleti" me katër fakultete.<sup>14</sup></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;</li> <li>• Fakulteti i Shkencave Mjekësore;</li> <li>• Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;</li> <li>• Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit;</li> </ul> <p>Universiteti "Barleti" ka hartuar "Strategjinë e zhvillimit institucional për periudhën 2020-2030". Zbatimi i kësaj strategjie gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen në këtë institucion.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit dhe është në përputhje me rregulloren e këtij fakulteti.<sup>15</sup></p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Staf i akademik i përfshirë në këtë program studimi zotëron grada dhe tituj shkencor dhe i kushton rëndësi pjesëmarrjes në projekte, kërkimit shkencor, si dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.<sup>16</sup></p>

<sup>14</sup> Vendim Nr. 571, datë 12.8.2005 për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti" & UMASR nr 213 date 03.07.2020. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>15</sup> Evidenca 1. Rregullore fakulteti FSHSTS. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>16</sup> Evidenca 7.2. Cv e stafit akademik.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>



<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Gjithashtu përputhshmëria konstatohet edhe në programet që ofrohen nga kjo njësi bazë<sup>17</sup> të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Master Profesional në Edukim, me Profil “Mësimdhënie dhe të nxënit”;</li> <li>• Master Profesional në Mësuesi në Arsim Special;</li> <li>• Master Profesional në Mësuesi në Arte;</li> <li>• Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim;</li> <li>• Master Profesional në mësuesi në shkencë Sociale.</li> </ul> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është kodifikuar me kodin: 72MP0114S. Ky kod është gjykuar duke u bazuar më interpretimin që bëhet në trajnimin për mësuesit me specializim lënde, mbështetur në faqen 84 të VKM. 288.<sup>18</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit që e ofron këtë program studimi dhe e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Programi Master Profesional (120 ECTS) në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi me dy vite akademike është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi.<sup>19</sup> <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve ...”, i ndryshuar.<sup>20</sup></i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion, konkludojmë se programi Master Profesional (120 ECTS) në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi me dy vite akademike është brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë kryesore dhe njësisë bazë ku është duke u</p>

<sup>17</sup> Evidenca 1. Rregullore fakulteti FSHSTS. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>18</sup> Evidenca 45. Vendim nr.310 date 11.05.2022 Kodifikimi.pdf Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>19</sup> "Barleti" University. Parë tek rubrika “Programet e Studimit” më Prill 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

<sup>20</sup> Evidenca 43. VKM Nr. 41, dt. 24.1.2018.pdf. Parë më Mars 2024, gjendet në <https://ascal.al/sq>

cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	ofruar. Ky program studimi ofrohet brenda profilit të Universitetit “Barleti”.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit mbështetet nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti “Barleti” me anë të Qendrës “Barleti Training Testing Center”, e cila ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar nga universiteti Barleti, por edhe nga universitete të tjera brenda vendit. Kjo qendër ofron module të akredituara nga MAS për mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar dhe gjithashtu ofron mbështetje edhe për studentët e këtij programi studimi të cilët janë në marrëdhënie pune.</p> <p>Kjo njësi bazë ofron trajnime profesionale edhe për drejtuesit dhe aspirantët për drejtor të Sistemit Arsimor Parauniversitar nëpërmjet marrëveshjeve me Shkollën e Drejtorëve. Një tjetër program me karakter trajnues që ofrohet në këtë njësi bazë është edhe Programi i Vazhduar në Formimin Psiko-Pedagogjik të licensuar nga MAS.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve ...”, i ndryshuar. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqëruar, rezultoi se Universiteti “Barleti” mbikëqyr mbarëvajtjen e programit të studimit nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive mes personelit akademik, siç është përgjegjësia e koordinatorit të programit<sup>21</sup> dhe përgjegjësitë e stafit akademik dhe stafit administrativ.<sup>22</sup></p> <p>Institucioni gjithashtu e mbikëqyr mbarëvajtjen e programit të studimit nga analiza e vazhdueshme e punës së bërë brenda departamentit<sup>23</sup> duke nxitur dhe mbështetur një marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis gjithë aktorëve në vazhdimësi.<sup>24</sup></p> <p>Gjithashtu institucioni ka hartuar rregullore të institucionit, rregullore të fakultetit, rregullore të çdo programi studimi, politika, procedura, udhëzues dhe manualë, përmes të cilave mbikëqyr mbarëvajtjen e programeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve që ofron. Marrëveshjet e bashkëpunimit konstatohen me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare<sup>25</sup> si edhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione bashkëpunuese brenda vendit për të zhvilluar praktikën profesionale.<sup>26</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës</p>	<p>Në mbështetje të realizimit të praktikave profesionale evidentohet që Universiteti “Barleti” bashkëpunon me një sërë institucionesh arsimore publike dhe jopublike.<sup>27</sup> Në marrëveshjet e bashkëpunimit parashikohet forma dhe</p>

<sup>21</sup> Evidenca 47. Urdher i Brendshëm Nr.29 datë 14.10.2022 Për emërim në detyrë të koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>22</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>


<sup>23</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

<sup>24</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>25</sup> Evidenca 58 Marrëveshjet e bashkëpunimit MoU.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>26</sup> 34.1. Marrëveshje Bashkëpunimi.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>27</sup> Evidenca 22.4. Lista e Praktikave të Studentëve në Institucionet ku kanë zhvilluar Praktikën Profesionale.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



<p>përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>realizimi në përmbajtje i praktikës profesionale të programeve “Master”.<sup>28</sup></p> <p>Për sa i përket kërkimit shkencor evidentohet që institucioni zhvillon konferenca në mënyrë periodike vetëm për stafin akademik ndërkohë që <i>rekomandohet të krijohet mundësi në mënyrë periodike edhe për kërkimin shkencor referuar studentëve</i>. Për sa i takon mobilitetit, pedagogë të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, në kuadër të ndërkombëtarizimit përmes Programit Evropian Erasmus+ kanë bashkëpunuar dhe shkëmbyer eksperiencë në mësimdhënie dhe trajnime<sup>29</sup> ndërkohë që <i>evidentohet një përfshirje e ulët e studentëve të këtij departamenti në mobilitete ndërkombëtare</i>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional harton raporte analitike të programeve që ofron për organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu analizohen përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit, si dhe rezultatet e arritura për punën e bërë.<sup>30</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti “Barleti” për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MPMTIK, nxit dhe siguron bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit, si edhe siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore publike dhe jopublike për të mbështetur zhvillimin e praktikave profesionale të përcaktuara në këtë program studimi në kuadër të aftësisimit profesional.</i></p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të krijojë mundësi studentëve të përfshihen në mënyrë periodike në veprimtari kërkimore shkencore, si edhe të rrisë mundësi studentëve të MPMTIK të përfshihen në shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p>

<sup>28</sup> Evidenca 2.3: UniBa Paketa e praktikës. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>29</sup> Evidenca 32. c. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>30</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga Univeriteti “Barleti”, evidentohet se programi Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi është organizuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Ky program është vlerësuar me 120 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndë bazë (Kategoria A: 11 kredite);</li> <li>- lëndë karakterizuese (Kategoria B/ 49 kredite);</li> <li>- lëndë ndërdisiplinore/integruese (Kategoria C/ 42 kredite);</li> <li>- lëndë plotësuese (Kategoria D/ 6 kredite);</li> <li>- detyrime përmbyllëse (Kategoria E/ 12 kredite);</li> </ul> <p>Rezulton gjithashtu që programi i studimit është mbështetur në:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjin Nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;</li> <li>• VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”;</li> <li>• Udhëzimi Nr.31 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 29.12.2017, kreu III, pika 1, akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>• Statutin e Universitetit “Barleti”;</li> <li>• Rregulloren e Universitetit “Barleti”;</li> <li>• Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve;</li> <li>• Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga analiza e kurrikulës së programit të Studimit<sup>31</sup>, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, konstatohet se përmbajtja e planit mësimor, synon që t’u mundësojë studentëve pajisjen e tyre me njohuritë e nevojshme për fitimin e kompetencave teorike dhe kompetencave praktike të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën profesionale. Gjithashtu, pas përfundimit me sukses të programit të studimit, studentit i mundësohet aftësimi i tij për zgjidhjen e situatave problemore/sociale/emocionale dhe me aftësi të përgjithshme të pavarura praktike dhe zbatuese. Përfundimi me sukses i programit të studimit u mundëson studentëve përfshirjen e drejtpërdrejtë në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues.</p> <p>Ky program studimi përmbush nivelin e 7 (Shtatë) të kornizës shqiptare të kualifikimeve.</p>

<sup>31</sup> Evidencë 3. Evidenca 2.1.b Plan mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga analiza e planit mësimor të programit të studimit, si dhe nga diskutimi me stafin e departamentit, konstatohet se programi i studimit Master Profesional në “ Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” parashikon ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale. Plani mësimor i programit MPMTIK, parashikon 12 kredite pas përfundimit të praktikës profesionale ( 6 kredite në semestrin e parë/ viti i dytë dhe 6 kredite të tjera në semestrin e dytë/ viti i dytë). Gjithashtu studenti fiton 12 kredite pas kalimit me sukses të detyrimit përmbyllës të përcaktuar në planin mësimor dhe në rregulloren e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, programi i studimit është organizuar në program studimi Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” me 120 kredite dhe është organizuar sipas fushave përkatëse të formimit të mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë. Në rregulloren e programit MPMTIK është përcaktuar se pjesë e formimit të mësuesve janë ata studentë që kanë studjuar programin bachelor në matematikë informatike, shkenca të natyrës, teknologji dhe TIK, inxhinieri mekanike, informatike, mekatronike.</p> <p>Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në diskutimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij programi, mund të konkludojmë se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri profesionale, të nevojshme për fushën e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së</p>	<p>Referuar planit mësimor të programit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi <sup>32</sup> evidentohet se programi organizohet me 120 kredite. Lëndët ndahen në lëndë bazë (Kategoria A: 11 kredite), lëndë karakterizuese (Kategoria B/ 49 kredite), lëndë ndërdisiplinore/integruese (Kategoria C/ 42 kredite), lëndë plotësuese (Kategoria D/ 6 kredite), si edhe detyrime përmbyllëse (Kategoria E/ 12 kredite). Përfundimi me sukses i programit të studimit kërkon ndjekjen e dy viteve akademike dhe në përfundim të programit studenti fiton 120 kredite/ECTS (60 kredite për çdo vit akademik).</p>

<sup>32</sup> Evidenca 2.1.a.Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>





<p>paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p><i>Rekomandohet që lënda "Praktikë profesionale" vendosur në kategorinë C, të kalojë në kategorinë D. Gjithashtu rekomandohet që të vendoset në planin mësimor një tregues që evidenton lëndën nëse është me detyrim ose me zgjedhje.</i></p> <p>Programi Master Profesional në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi me dy vite akademike përmban 25% lëndë të formimit psiko-pedagogjik. Duke qenë programi i parë Master Profesional me 120 kredite që zhvillohet nga IAL-të në Shqipëri ai në periudhën e licensimit ka analizuar planet mësimore të programeve master që lidhen me Masterin Profesional në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, si edhe me planin mësimor me 60 kredite të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, ku evidentohet se ka lëndë të njëjta me to.</p> <p><i>Grupi i vlerësuesve të jashtëm nuk mund ta konfirmojë apo rrëzojë këtë pohim për shkak se në dokumentacionin shoqërues nuk gjenden burime referuese për këtë tregues.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar konstatohet se Universiteti "Barleti" nuk është me status të veçantë, në kuptim të nenit 84 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë". Për këtë shkak, kriteri 6 nuk merret në analizë prej grupit të vlerësuesve të jashtëm.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit <sup>33</sup> të dorëzuar dhe nga verifikimi me takimin me drejtuesin e departamentit, konstatohet se programi Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi është mbështetur në bazën ligjore në fuqi. Ky program studimi zhvillohet për herë të parë në Univeritetin Barleti dhe respekton 25% lëndë të formimit psiko-pedagogjik<sup>34</sup>.</p>

<sup>33</sup> Evidenca 4. Studimi i tregut të punës për programin e studimit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>34</sup> Evidenca 2.1.a.Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	<p>Në RVB pohohet se përpara periudhës së licencimit, janë analizuar planet mësimore të programeve master, si MP në Teknologji informacioni dhe komunikimi me planin mësimor me 60 kredite në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, ku evidentohet se ka lëndë të njëjta me to. <i>Grupi i vlerësuesve të jashtëm nuk mund ta konfirmojë apo rrëzojë këtë pohim për shkak se në dokumentacionin shoqërues nuk gjenden burime referuese për këtë tregues.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është kodifikuar me kodin: 72MP0114S. Ky kod është gjykuar duke u bazuar më interpretimin që bëhet në trajnimin për mësuesit me specializim lënde, mbështetur në faqen 84 të VKM. 288, Datë 11.05.2022 “Për miratimin e klasifikimit standard ndërkombëtar të arsimit KSNA2011 (ISCED 2011), të fushave të arsimit dhe të trajnimit të KSNA2013 (KSNA-F 2013) dhe të përshkrimeve të tyre të detajuara”<sup>35</sup></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Grupi i vlerësuesve të jashtëm, ashtu si edhe grupi i vlerësuesve të brendshëm, konstatoi se programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, që ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve i Universitetit “Barleti”, nuk është program i përbashkët mes dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-9 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vërehet se programi i studimit MPMTIK përmbush kriteret ligjore për ndërtimin dhe zbatimin e kurrikulës së tij, ofron formim akademik dhe praktik të domosdoshëm, ndërsa plani mësimor dhe përmbajtja e tij, me anë të lëndëve bazë, të formimit profesional, apo detyrimet përmbyllëse respektojnë kriteret ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<sup>35</sup> Evidenca 45. Vendim nr.310 date 11.05.2022 Kodifikimi.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nga evidencat përkatëse që e shoqërojnë, por dhe nga takimet me dekanin, me përgjegjësin e departamentit dhe me stafin që mbulon programin, rezulton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Ai e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Organizimi i njësive kryesore/bazë bëhet në referencë të Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, sipas të cilit kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që <i>njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.</i></p> <p>Referuar të dhënave tabelore për personelin akademik<sup>36</sup> rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 77 pedagogë, nga të cilët 38 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 30 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1" data-bbox="592 1485 1433 1825"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>5</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>13</td> <td>23</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit		PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	Prof.Asoc	5	4	Dr/PhD	13	23
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit														
	PAE	PAK													
Prof.Dr	1	1													
Prof.Asoc	5	4													
Dr/PhD	13	23													

<sup>36</sup> Evidenca 23. Te dhena tabelore per 3 vitet e fundit personelin akademik MPTIKTabela 1 & 2.pdf



	Msc	19	11		
	<b>Gjithsej</b>	<b>38</b>	<b>39</b>		
<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit MPMTIK përbëhet aktualisht nga 8 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE), nga të cilët (2) me tituj Prof. Asoc. Dr, (4) Dr./PhD, si edhe (2) me Msc. Gjithashtu në departament janë të përfshirë edhe 4 antarë të personelit akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Tabela më poshtë pasqyron personelin akademik të njësisë përgjegjëse (Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional) për vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024.<sup>37</sup></p>					
		<b>2022-2023</b>		<b>2023-2024</b>	
	<b>Tituj/ grada</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>
	Prof.Dr.	-	-	-	-
	Prof. Asoc.	1	1	2	1
	Dr./PhD.	4	1	4	3
	Msc.	2	-	2	-
	<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>4</b>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave	<p>Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit rezultoi që Universiteti “Barleti” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. UniBa ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikës profesionale.<sup>38</sup> Gjatë takimit me përgjegjësin e departamentit dhe stafin e përfshirë në program u konstatua që për zhvillimin e praktikave profesionale janë të ngarkuar 6 anëtarë të stafit që mbulojnë koordinimin për programet e fushës së mësuesisë që departamenti ofron.</p>				

<sup>37</sup> Evidenca 23. Te dhena tabelore per 3 vitet e fundit personelin akademik MPMTIK Tabela 1 & 2.pdf

<sup>38</sup> Evidenca 22.4. Lista e Praktikave të Studentëve në Institucionet ku kanë zhvilluar Praktikën Profesionale.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

mësimore, laboratorike e klinike, etj.									
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit dhe takimit me përgjegjësën e departamentit rezultoi se departamenti ka një koordinator për programet e studimit. Mbështetur në vendimin Nr. 26, datë 14.10.2022 është emëruar në detyrën e Koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional Dr. Adriana Qafa. <sup>39</sup>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, si njësi bazë e caktuar për zhvillimin e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme	<p>Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit evidentohet se informacioni i nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit gjendet në dokumentet kryesore rregulatore të njësisë kryesore/bazë që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e Universitetit “Barleti”<sup>40</sup></li> </ul>

<sup>39</sup> Evidenca 47. Urdher i Brendshëm Nr.29 datë 14.10.2022 Për emërim në detyrë të koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>40</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<p>për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve<sup>41</sup></li> <li>• Rregullore e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional<sup>42</sup></li> <li>• Rregullore e programit Master Profesional “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”<sup>43</sup></li> <li>• Plani mësimor Master Profesional “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”<sup>44</sup></li> <li>• Syllabuset e lëndëve<sup>45</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit, përkatësisht të planit mësimor dhe të programeve lëndore evidentohen informacionet e nevojshme për kreditet e lëndëve, ngarkesën javore<sup>46</sup> dhe ngarkesën e përgjithshme<sup>47</sup> mësimore në auditor/jashtë auditorit dhe detyrimet në përfundim të lëndës/modulit (provim)<sup>48</sup>. Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi me dy vite akademike është program i ciklit të dytë të studimeve me 4 semestra. Afati maksimal i studimeve është 4 vite akademike.<sup>49</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullat që duhet të ndiqen nga studentët lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve përcaktohen me detaje në rregulloren e programit të studimit MPMTIK. Kjo rregullore parashikon kushte dhe kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në program. Procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve përcaktohen në nenin 22 të këtij dokumenti. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/ program të mëparshëm studimi parashikohet në rregulloren e FSHSTS<sup>50</sup>. Gjithashtu, studentët e interesuar mund të informohen mbi kriteret e përmendura më</p>

<sup>41</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>42</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Departamenti të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>43</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>44</sup> Evidenca 2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>45</sup> Evidenca 16.6. Formulari për transparencë të vlerësimit.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>46</sup> Evidenca Orari sem2, 23-24.pdf/ Evidenca Orari sem 1, 22- 23.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>47</sup> Evidenca shtese 4. Evid.1. a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>48</sup> Evidenca 2.6. Programet lënd ore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>49</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>50</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	sipër edhe përmes informacionit të dhënë në faqen zyrtare të Universitetit “Barleti”			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore (syllabuset) <sup>51</sup> përmbajnë të gjitha elementët e kërkuar nga VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe tregojnë emrin e plotë të lëndës, pedagogun përgjegjës, ngarkesën, tipologjinë, vitin akademik, llojin e lëndës, temat themelore, qëllimet dhe rezultatet e të nxënit, format e kontrollit të dijeve, frekuentimin, si edhe literaturën bazë dhe atë të rekomanduar.			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik. Rishikimi bëhet në konsultim me hapat e përcaktuara në rregulloren e Universitetit “Barleti” dhe sipas udhëzimeve ministeriale. GVJ evidentoi se në këtë program studimi nuk janë reflektuar ende përditësimet sepse ky program është në proces akreditimi.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL vërehet se programi i studimit MPMTIK përmban gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit të tillë si planin mësimor, ngarkesën mësimore, programet lëndore, si edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<sup>51</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<b>Standardi II.4</b>																					
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>																					
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																				
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. Në kurrikulën e programit të studimit MPMTIK është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si lëndë <sup>52</sup> dhe veprimtaria formuese përkatëse. Referuar evidencës së planit mësimor të programit të studimit MPMTIK <sup>53</sup> , <i>rekomandohet që lënda në numrin rendor 13 (Praktika profesionale) e përcaktuar në kategorinë C (Lëndë ndërdisiplinore/Integruese) të kalojë në kategorinë D (Lëndë plotësuese).</i>																				
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Mbështetur në shqyrtimin e planit mësimor të programit MPMTIK u evidentua shpërndarja e ngarkesës mësimore në 4 semestrat e realizimit të programit, e cila është e balancuar për çdo semestër.  Ngarkesa mësimore javore në auditor është  <table border="0"> <tr> <td>1. Semestri I</td> <td>30 kredite</td> <td>15 javë</td> <td>15 orë në javë</td> </tr> <tr> <td>2. Semestri II</td> <td>30 kredite</td> <td>15 javë</td> <td>15 orë në javë</td> </tr> <tr> <td>3. Semestri III</td> <td>30 kredite</td> <td>15 javë</td> <td>21 orë në javë</td> </tr> <tr> <td>4. Semestri IV</td> <td>30 kredite</td> <td>15 javë</td> <td>18 orë në javë</td> </tr> </table> Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve në semestra mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit.  Ngarkesa totale vjetore e orëve në auditor dhe orë pune të pavarur është:  <table border="0"> <tr> <td>1. Viti i parë</td> <td>1500 orë</td> </tr> <tr> <td>2. Viti i dytë</td> <td>1500,3 orë</td> </tr> </table>	1. Semestri I	30 kredite	15 javë	15 orë në javë	2. Semestri II	30 kredite	15 javë	15 orë në javë	3. Semestri III	30 kredite	15 javë	21 orë në javë	4. Semestri IV	30 kredite	15 javë	18 orë në javë	1. Viti i parë	1500 orë	2. Viti i dytë	1500,3 orë
1. Semestri I	30 kredite	15 javë	15 orë në javë																		
2. Semestri II	30 kredite	15 javë	15 orë në javë																		
3. Semestri III	30 kredite	15 javë	21 orë në javë																		
4. Semestri IV	30 kredite	15 javë	18 orë në javë																		
1. Viti i parë	1500 orë																				
2. Viti i dytë	1500,3 orë																				

<sup>52</sup> Evidence 5. Paketa e praktikës profesionale.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>53</sup> Evidenca shtese 4. Evid2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>



	<p><i>Rekomandohet që të rishikohet llogaritja e ngarkesës totale vjetore e vitit të dytë që të jetë e njëjtë me vitin e parë në orë mësimore pune të studentit.</i></p> <p>Referuar rregullores së programit<sup>54</sup> në Kreun II, Neni 15, pika 2 janë parashtruar natyra e lëndëve me zgjedhje, ndërkohë që në planin mësimor të programit mungojnë lëndët me zgjedhje. <i>Rekomandohet që në programin e studimit MPMTIK të krijohet hapësirë studentëve për lëndë me zgjedhje me qëllim krijimin dhe rritjen e mundësisë për përshtatje dhe integrim në tregun e punës.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 4 semestrat e realizimit të programit është e balancuar për çdo semestër. Referuar strukturës së planit mësimor të programit MPMTIK evidentohet se gjatë vitit të parë të studimeve, lëndët me natyrë karakterizuese zënë pjesën më të madhe të programit nëpërmjet të cilave sigurohet aftësi, kompetenca dhe formim i thelluar profesional. Gjithashtu në këtë vit trajtohen edhe lëndët e formimit bazë (Tipi i veprimtarisë A). Ndërkohë që në vitin e dytë rritet përqindja e njohurive dhe aftësive të lëndëve që lidhen me natyrën ndërdisiplinore dhe plotësuese. Struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e programit të studimit. Ndonëse në RVB pretendohet se raporti teori-praktikë është në përputhje edhe me programe të ngjashme kombëtare, në dokumentacionin shoqërues të RVB-së nuk janë treguar referenca për të mbështetur një pretendim të tillë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion konstatohet se për të mundësuar arritjen e objektivave formues është organizuar një ndarje sipas veprimtarive formuese përkatëse të parashikuara sipas udhëzimeve të MAS. <i>Referuar planit mësimor të MPMTIK<sup>55</sup>, rekomandohet modifikim i programit të studimit në mënyrë që kreditet e lëndëve ndërdisiplinore/integruese të jenë midis 20-30 përqind të krediteve totale sepse shpërndarja e kësaj ngarkese sipas planit mësimor, e ndarë në vite, semestra, apo javë mësimore, garanton arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p> <p>Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, programi i</p>

<sup>54</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>55</sup> Evidenca shtese 4. Evid2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>



	<p>studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, u mundëson studentëve kualifikimin e nevojshëm teorik/praktik duke mundësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ kryerjen e studimeve të thelluara në mësimdhënie dhe nxënie sipas metodave bashkëkohore duke synuar nivelin shtatë të kornizës shqiptare të kualifikimeve;</li> <li>○ një formim profesional në fushën përkatëse të edukimit në mbështetje të tregut të punës.</li> </ul> <p>Gjithashtu, përfundimi me sukses i programit të studimit u mundëson studentëve që të përfshihen drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit rezulton se bëhen përpjekje për përditësimin e përmbajtjes së kurrikulës në përputhje me ndryshimet dhe risitë sidomos në literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Njësia bazë nëpërmjet një email i drejton përgjegjësit të bibliotekës kërkesën për shtimin e titujve të librave bashkëkohor të miratuara në departament. Literatura paraqitet në syllabuset lëndor krahas literaturës në bibliotekë, asaj online dhe asaj në intranet<sup>56</sup>.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve<sup>57</sup> të programit identifikohet se literatura është paraqitur në çdo program lëndor.</p> <p><i>Rekomandohet që syllabuset të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me literaturë bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimit, bazohet në VKM-në nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional,<sup>58</sup> si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>59</sup> parashikohen aftësitë dhe kompetencat</p>

<sup>56</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve-periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>57</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>58</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Departamenti të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP).pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>59</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.			
<b>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</b>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara me përgjegjës të departamentit dhe stafin e përfshirë në këtë program u evidentua që të diplomuarit mund të punësohen si mësues të të gjithë ciklet: në kopshte, në shkolla të arsimit bazë , në shkolla të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë, por dhe në institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore të arsimit lidhur me zhvillimin dhe politikbërjen arsimore.</p> <p>Mbështetur në shqyrtimin e Rregullores së programit MPMTIK<sup>60</sup>, <i>rekomandohet rishikim i Aneksi II: Mundësi punësimi që të përputhet plotësisht me profilin e programit MPMTIK</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL u konstatua se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë.</i></p> <p><i>Rekomandohet modifikim i planit mësimor të programit të studimit në mënyrë që kreditet e lëndëve ndërdisiplinore/integruese të jenë midis 20-30 përqind të krediteve totale për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu rekomandohet që në kurrikulën e programit të studimit MPMTIK të krijohet mundësia e grup-lëndëve me zgjedhje.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<sup>60</sup> Evidenca 3, Rregullore e programit MPMTIK.pdf, Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe stafin e programit u konstatua se departamenti ka analizuar tregun e punës<sup>61</sup> me qëllim hartimin, përmirësim, dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit. Në universitetin “Barleti” studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së studimeve. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime studentët nëpërmjet;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet çdo semestër para provimeve nga NJZhKC;<sup>62</sup></li> <li>• Përfshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë;<sup>63</sup></li> </ul> <p>Gjithashtu departamenti harton në mënyrë periodike Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit<sup>64</sup>, ku analizon qasje dhe këndvështrime të tregut, institucioneve partnere si edhe konkurrencës, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të tij me tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si edhe me studentët, rezultoi se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët që të shkëmbejnë ide për funksionimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Siç është trajtuar edhe në kriterin më lart, studentët përfshihen zyrtarisht në proceset e anketimeve nëpërmjet të cilave merren mendimet e tyre në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Ky program studimi është në proces dhe akoma nuk ka studentë të diplomuar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet që Universiteti “Barleti” për programin e studimit MPMTIK ka analizuar tregun e punës<sup>65</sup> i cili e drejton programin për të përmbushur nevojat e tij. Siç është përmendur edhe më parë në këtë RVJ, ky program studimi është në përputhje edhe me propozimet dhe zhvillimet e</p>

<sup>61</sup> Evidenca 4. Studimi i tregut te punes per programin e studimit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>62</sup> Evidenca 16.4. Formular i vleresimit te lendes dhe pedagogut nga studentet.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>63</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit te studentit 22-23, sem I.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>64</sup> Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të Departamentit.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>65</sup> Evidenca 4. Studimi i tregut te punes per programin e studimit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	fundit në fusha të ndryshme, me qëllim kryesor përshtatjen e programeve lëndore në përputhje me planin strategjik të institucionit dhe me ndryshimet ligjore.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se IAL-ja nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit për realizimin me sukses së objektivave të programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit konkludohet se programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në mësimdhënie dhe të nxënit për profilin e mësuesisë. Programi MPMTIK synon një formim profesional, bashkëkohor në këtë fushë, si edhe ofron përgatitje tërësore, profesionale për të gjithë studentët e tij lidhur me ofrimin e identifikimit, trajtimit, mbështetjes dhe zhvillimit të fëmijëve/ nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.</p> <p>Programi ka këto objektiva:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrton Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, nën këndvështrimin e zbatimit cilësor të saj në AP (AF+AMU+AML), të lidhura me kompetencat në fushën e TIK;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikon dhe të zhvillojë kurrikulën e AP në mënyrë efektive për formimet si: teknologji dhe TIK, matematikë, shkenca të natyrës, inxhinierë IT dhe mekatronike në të gjitha fushat;</li> <li>- Përdor metoda, teknika dhe strategji për zhvillimin e një mësimdhënie dhe të nxënë të frytshëm në AP për teknologji dhe TIK;</li> <li>- Zhvillon metodologji të efektshme për zbatimin e Kurrikulës së TIK në AP, duke identifikuar dhe përdorur ato me të mirat dhe bashkëkohoret, për krijimin e kompetencave përkatëse nga nxënësit;</li> <li>- Analizon teorikisht dhe zbaton në praktikë mënyrat e mësimdhënies dhe modelet e të nxënës, duke mbajtur qëndrime kritike lidhur me metodat e ndryshme, që duhet të përdorin në grupmosha në nivele të ndryshme, 6-18 vjeç;</li> <li>- Demonstron të kuptuarit në kontekstin shkollor dhe atë të praktikës së përditshme sipas zhvillimeve teknologjike në mosha të ndryshme;</li> <li>- Zbaton në praktikë modele, teknika strategji të frytshme për menaxhimin e klasës, motivimin, matjen e dijeve të nxënësve;</li> <li>- Zbaton akte dhe nën akte ligjore, si edhe politikat zyrtare për APU;</li> </ul> <p><i>Rekomandohet që programi i studimit MPMTIK të përcaktojë në rregulloren e tij objektiva që lidhen dhe me kërkimin shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësisë bazë, stafin e përfshirë në program dhe studentët u konstatua se njësia kryesore dhe njësia bazë bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies <sup>66</sup>, si edhe veprimtaritë kërkimore shkencore <sup>67</sup> duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.</p>

<sup>66</sup> Evidence Orari scm2, 23-24.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>67</sup> Evidenca 32.b. Lista e Konferencave dhe workshopeve.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor MPMTIK konstatohet se programi i studimit i mundëson studentëve fitimin e njohurive dhe krijimin e shkathtësive kërkimore nëpërmjet lëndës “Metodat e kërkimit të avancuar”.<sup>68</sup></p> <p>Mbështetur në rregulloren e studimit është evidentuar në Kreu II, Neni 4, pika 3 “Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë.....” duke mos mundësuar studentët të përfshihen në studim dhe aktivitet kërkimor për të krijuar mundësinë e përmbjlljes së studimeve dhe me mbrojtjen e një teze diplome.<sup>69</sup></p> <p><i>Rekomandohet që programi i studimit MPMTIK në rregulloren e tij, të krijojë mundësi studentëve të përmbjllin studimet edhe me punim kërkimor shkencor në formën e një teze diplome.</i></p> <p>Mbështetur në dokumentacion<sup>70</sup> dhe takimet e zhvilluara me studentët e programit MPMTIK, u konstatua një mungesë e përfshirjes së tyre në aktivitete kërkimore.</p> <p><i>Rekomandohet krijim i mundësisë së konferencave periodike studentore me qëllim nxitjen për përfshirje dhe angazhim në studime dhe aktivitete kërkimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me stafin e përfshirë në program dhe përfaqësues të zyrës së kërkimit shkencor, si edhe dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se pedagogët e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe më gjerë mbështeten financiarisht nga universiteti duke marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga UniBa pa pagesë.</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të mbështet stafin financiarisht për publikimin e punimeve kërkimore në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të rankuara me faktor impakti.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kritereve 1-4 të standardit II.6, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se programi i studimit garanton orientim të fushës së studimit.</i></p>

<sup>68</sup> Evidenca 2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>69</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>70</sup> Evidenca 32.a. Lista e Konferencave dhe ëorkshopeve.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	<i>Rekomandohet që rregullorja e programit të studimit MPMTIK, të përcaktojë objektiva që lidhen specifikisht me kërkimin shkencor, si edhe të krijojë mundësi studentëve të përmbyllin studimet edhe me punim kërkimor shkencor në formën e një teze diplome.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Referuar dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara në institucion u konstatua se departamenti, nëpërmjet Institutit të Edukimit “Barleti” (IBE) dhe nga bashkëpunimet me BIRD dhe AIPA ka zbatuar dhe ka mbështetur projekte në fushën e edukimit, por edhe në shumë disiplina të tjera që ofron universiteti, të cilat mbështetin proceset kërkimore të stafit akademik. Departamenti gjithashtu, në kuadër të ndërkombëtarizimit, nëpërmjet Programit Evropian Erasmus+ ka bashkëpunuar dhe ka shkëmbyer përvoja profesionale me disa universitete evropiane për fushën e trajnimit dhe mësimdhënies <sup>71</sup> me qëllim rritjen e cilësisë të programeve që UniBa ofrohen.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezultoi se personeli akademik dhe ai mbështetës nxiten të kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor <sup>72</sup> , si edhe angazhohen në projekte kërkimore shkencore. Siç trajtohet edhe në RVB, “Universiteti Barleti” ka themeluar institutet dhe qendrat e listuar më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Instituti i Kërkim Zhvillimit “Barleti” IKZHB (BIRD);</li> <li>• Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike ISHÇP (AIPA);</li> <li>• Instituti i Edukimit “Barleti” IEB (BEI);</li> </ul>

<sup>71</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>72</sup> Ancks-Tabela 19- Te dhena tabelore per kerkimin shkencore te stafit akademik.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Instituti ADRIAPOL Kërkim, Zhvillim, Rritje, Inovacion;</li> <li>• Qendra YOUTH ACT;</li> <li>• Qendra Education in United States "EDUSA".</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezultoi se njësia përgjegjëse ka organizuar aktivitete mësimore dhe kërkimore shkencore që të ndihmojnë personelin akademik që të përmbushin arritjen e objektivave.</p> <p><i>Rekomandohet që të ketë më shumë aktivitete që lidhen me fushën e programit të studimi të cilat ndihmojnë studentët në arritjen e objektivave formuese.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion u konkludua se programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu u konstatua se në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ushtron veprimtarinë edhe Bordi i Karrierës. Qëllimi i formalizimit të këtij Bordi është përmirësimi i kurrikulave dhe programeve në funksion të integritimit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, u vumë në dijeni që strukturat e ngritura në fakultet dhe departamenti janë përherë të vëmendshëm ndaj ndryshimeve dhe akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Programi i studimit MPMTIK akoma nuk ka diplomuar studentë që të jenë në procesin e licensimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se programi i studimit<sup>73</sup> përputhet me aktet ligjore për të mbështetur studentët të fitojnë licensën për mësues të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sistemin arsimor parauniversitar.</p> <p>Programi i studimit MPMTIK është program studimi që hyn tek profesionet e rregulluara sipas ligjit Nr. 10. 171, datë 22.10.2009,</p>

<sup>73</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	<p>“Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.          Studenti merr licensën pasi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ka marr diplomën në MPMTIK;</li> <li>2. Ka kryer praktikën profesionale;</li> <li>3. Ka marrë provimin e shtetit.</li> </ol>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit II.7, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke garantuar njohuri të thelluara për fushën e studimit.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të krijohet mundësi studentëve të MPMTIK të përfshihen në mobilitete dhe në aktivitete kërkimore shkencore që lidhen me fushën e programit të studimi të cilat i ndihmojnë në arritjen e objektivave formuese.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### III MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERESIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit, konstatohet se program i studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni



<p>seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>dhe komunikimi zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret e IAL dhe FSHSTS. Kjo evidentohet me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- planit mësimor të programit të studimit MPMTIK<sup>74</sup>,</li> <li>- me anë të programeve lëndore (syllabuseve)<sup>75</sup>,</li> <li>- specifikohet dhe në Kreu II, Neni 11, në Rregulloren e Programit të studimit MPMTIK<sup>76</sup>.</li> <li>- Udhëzuesit të mësimdhënies dhe të nxënit në arsimin e lartë<sup>77</sup></li> <li>- Rregullores së Departamentit<sup>78</sup> / Fakultetit<sup>79</sup> / Universitetit<sup>80</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se personeli akademik u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Gjithashtu u konstatua se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni e mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Universiteti “Barleti” zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit akademik. Format e mbështetjes janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mobilitete ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe mësimdhënies<sup>81</sup></li> </ul>

<sup>74</sup> Evidenca 2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>75</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>76</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>


<sup>77</sup> Evidencë Shtesë 3. Udhëzues për Mësimdhënien.pdf

<sup>78</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Departamenti të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>79</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf

<sup>80</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>81</sup> Evidenca 32. c. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzues i mësimdhënies dhe të nxëniet në shkollën e lartë<sup>82</sup></li> <li>- Leksione të hapura dhe trajnime<sup>83</sup></li> <li>- Kualifikime dhe specializime jashtë institucionit<sup>84</sup></li> <li>- Vëzhgime për përmirësimin e kompetencës didaktike nga ana e vetë pedagogëve bazuar në fushat e tyre të studimit, duke përdorur teknikën “peer to peer”<sup>85</sup>.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të CV-ve<sup>86</sup> të personelit akademik dhe llojin e lëndës<sup>87</sup> që zhvillon, rezulton se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo anëtar i stafit akademik e zhvillon mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion u konkludua mbështetje në marrëdhëniet e krijuara me respekt të ndërsjellët mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se njësia përgjegjëse për programin e studimit i përfshinë studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, organizimin dhe përmbajtjen e lëndës, komponentët e vlerësimit dhe materialet që përdoren për lëndën. Formulari i vlerësimit të studentëve<sup>88</sup> shërben si një instrument matës dhe vlerësues për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Të dhënat e përfituara nga formulari i vlerësimit janë objekt analize në kuadër të</p>

<sup>82</sup> Evidenc Shtes 3.Udhezues per Mesimdhenien.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>83</sup> Evidenca 13a. Linqet e Veprimtarive te Departamentit per Trajnime dhe Pedagoge te Ftuarë..pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>84</sup> Evidenca 7.2. Cv e stafit akademik.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>85</sup> Evidenca 16.5. Formulari Peer Evaluation of Teaching.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>86</sup> Evidenca 7.2. Cv e stafit akademik.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>87</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>88</sup> Evidenca 16.4. Formular i vleresimit te lendes dhe pedagogut nga studentet.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	sigurimit të brendshëm të cilësisë.
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel institucioni, puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC).<sup>89</sup> Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe krijimit të kulturës së cilësisë në institucion. Gjithashtu institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit<sup>90</sup> i cili mbështet NJZHKC.</p> <p>GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit, i cili plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri para provimeve. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kritereve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se institucioni garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin. Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit përdor forma të larmishme të mësimdhënies, të të nxëniet, si edhe të transmetimit të dijeve. Këto forma i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga një personel akademik që zhvillon ato lëndë mësimore që janë në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre</i></p>

<sup>89</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKS).pdf

<sup>90</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në Universitetin “Barleti” kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve parashikohet kryesisht në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregulloren e Universitetit “Barleti”<sup>91</sup></li> <li>- Rregulloren e programit të studimit<sup>92</sup></li> <li>- Në programet lëndore (syllabusët)<sup>93</sup></li> </ul> Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar evidentohet se në rregulloren e programit të studimit, kreu III, neni 17, si edhe në syllabusët e lëndëve theksohen në mënyrë specifike kriteret dhe format e vlerësimit të studentit.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabusët e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli informojnë studentët për format e vlerësimit të njohurive dhe aftësive, për metodologjinë e testimit, për detyrimet lëndore së bashku me afatet për secilin detyrim që mbështesin vlerësimin formues dhe përmbledhës të studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Konstatojmë se, nga shqyrtimi i dokumentacionit, <sup>94</sup> vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore

<sup>91</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>92</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>93</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabusët).pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>94</sup> Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim te Senatit Akademik Nr. 7, date 28032023.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Komponentët e vlerësimit sipas peshës përkatëse në përqindje të pasqyruara në syllabusët e lëndëve<sup>95</sup> janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimi i ndërmjetëm 20% të notës përfundimtare;</li> <li>- Pjesëmarrje dhe aktivizim 10% të notës përfundimtare;</li> <li>- Detyra e kursit 20% të notës përfundimtare;</li> <li>- Provimi përfundimtar 50% të notës përfundimtare.</li> </ul> <p>Studenti është i detyruar të frekuentojë 50% të seancave të leksioneve dhe 75% të seancave të ushtrimeve (seminare, laboratorë, praktika).</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se për vlerësimin e studentëve përdoren kriterë të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument rregullator që lidhet me kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren e studimeve. Siç është përmendur edhe më lartë pedagogu i lëndës në vlerësimin përfundimtar mbështetet në vlerësimin e provimit të ndërmjetëm, pjesëmarrjes dhe aktivizimit, detyrën e kursit dhe provimin përfundimtar.</p> <p>Këto forma testimi dhe detyrash u japin mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë e tyre dhe të mbrojnë</p>

<sup>95</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale parashikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve. <sup>96</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, u konstatua se testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive në Universitetin “Barleti” realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (testimet me shkrim dhe ato me gojë), si dhe format elektronike si hartimi, dërgimi elektronik dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. U konstatua gjithashtu se institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si google classroom ku janë të përfshira edhe forma të vlerësimit elektronik.
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar shqyrtimit të rregullores së programit MPMTIK, evidentohet që në Kreun III janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentit. Gjithashtu kriteret e vlerësimit të studentit janë të përcaktuara dhe në syllabuset e lëndëve <sup>97</sup> . Studentëve në të njëjtën kohë u bëhet e ditur mënyra e vlerësimit të dijeve dhe njohurive në javën e parë mësimore nga pedagogu i lëndës, duke shtuar se përveç mënyrës së treguar në mënyrë të përgjithshme në rregulloren e programit të studimit, çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit dhe miratimit të programeve lëndore përcakton edhe mënyrën konkrete të vlerësimit për çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se stafi akademik gjatë zhvillimit të lëndës u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre në përvetësimin e njohurive gjatë seminareve, testeve të ndërmjetme, prezantimeve të detyrave të kursit duke u dhënë këshilla dhe orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Në raste të caktuara pedagogu i lëndës shpreh

<sup>96</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>97</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



	gatishmëri të japë mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në rregulloren e programit të studimit MPMTIK <sup>98</sup> dhe në Kodin e Etikës <sup>99</sup> së Universitetit Barleti është përcaktuar moslejimi dhe janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që të shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit dhe realizimit të detyrave.
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezultoi se vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me Rregulloren e Universiteti “Barletit” <sup>100</sup> , rregulloren e programit të studimit MPMTIK <sup>101</sup> , si dhe sipas disa kritereve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve <sup>102</sup> . Siç është paraqitur edhe në RVB, vlerësimet dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në regjistrin e rezultateve akademike.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referua shqyrtimit të rregullores së Universitetit “Barleti” konstatohet se në, Kreu VII, Neni 89 dhe 90 trajtojnë procedurën e ankimimit për zhvillimin e provimit dhe për vlerësimin. Referuar shqyrtimit të rregullores së programit <sup>103</sup> , Kreu VI, Neni 28, Pika 2 i jep të drejtë studentit të kërkojë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të dijeve dhe të ecurisë së tij gjatë viteve, por në këtë rregullore nuk parashikohet procedura e ankimimit që duhet të ndjek studentit për të përmbushur këtë të drejtë.  <i>Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit të MPMTIK të parashikohet procedura e ankimimit të studentit.</i>
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më	Nga takimet e zhvilluara me studentët u konstatua se ata ishin të informuar mbi të drejtën e tyre për ankimim. Me shpalljen e rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e

<sup>98</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>99</sup> Evidenca 33. Kodi i Etikës.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>100</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>101</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>102</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>103</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>



<p>pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore<sup>104</sup>. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit. Brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani brenda 48 orëve ngre një komision <i>ad-hoc</i> i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar ose përsëritjen e provimit me komision të miratuar nga dekanin.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kritereve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Universiteti “Barleti” siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</i></p> <p><i><u>Rekomandohet</u> që në rregulloren e programit të studimit të MPMTIK të parashikohet edhe procedura e ankimimit të studentit në përputhje me rregulloren e universitetit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi III.4</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se program i studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi synon t’i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në fushën e psiko- pedagogjisë dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</p> <p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë në kurrikulën e TIK, si dhe përmbillet me provimin përfundimtar. Në këtë program studimi është parashikuar lënda “Praktikë</p>

<sup>104</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

	Profesionale”, e cila ndihmon studentin të aplikojë në praktikë njohuritë e përftuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit MPMTIK <sup>105</sup> synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike dhe në fushën e ndërveprimit dhe aftësi të tjera kurrikulare si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndë për aftësim praktik në TIK (Programim me Mobile dhe desktop, Programim OO në C++, Menaxhim sistemesh informacioni);</li> <li>• lëndë për aftësim ndërveprimi (Edukimi dhe bashkëpunimi me prindërit)</li> <li>• lëndë për aftësi kërkimore (Metodat e kërkimit të avancuar)</li> <li>• lëndë për aftësi menaxhuese (Menaxhim i klasës)</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me studentët e programit të studimit MPMTIK, rezultoi se në përfundim të secilës lëndë pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara. Studentët qartësohen për metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale që lidhen me programin lëndor. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se nga ana e tyre në mënyrë të vazhdueshme mbështeten, orientohen dhe udhëzohen studentët në realizimin e detyrave të caktuara. Gjithashtu studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final si edhe për peshën që do të ketë në notën finale të lëndës/modulit.
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatojmë se programi synon të krijojë tek studentët njohuri, aftësi, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, si në nivelin teorik <sup>106</sup> ashtu edhe në atë praktik <sup>107</sup> nëpërmjet mësimdhënies e mbështetur në kompetenca. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme të parashikuara dhe në syllabuset e të gjitha lëndëve. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës

<sup>105</sup> Evidenca 2.1.b. Plani mesimor MPTIK.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>106</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>107</sup> Evidenca 2.3 UniBa\_Paketa e praktikës.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<p>grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>në grup për raste interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të zbatimit real, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe gjetjen e zgjidhjes duke punuar në grup.</p> <p>Në të njëjtën kohë Universiteti “Barleti” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me IAL në vend<sup>108</sup> dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +<sup>109</sup>. Në këtë program studimi nuk ka pasur studentë që kanë qenë përfitues të mobiliteteve.</p> <p><i><u>Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.</u></i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara me stafin akademik, si edhe dokumentacionit<sup>110</sup> të vënë në dispozicion nga institucioni, u evidentua se Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional nëpërmjet personelit akademik efektiv të përfshirë në programin e studimit ka realizuar leksione të hapura që lidhen me gjithëpërfshirjen në arsim. Gjithashtu orë të hapura janë zhvilluar edhe nga profesorë të huaj të ftuar për eksperiencën dhe ekspertizën e tyre në lidhje me zhvillimet e reja në fushën kërkimore shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Universiteti “Barleti” nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara duke ofruar mbështetje nëpërmjet instituteve “UniBa” të cilat janë përmendur edhe më lart.</p> <p><i><u>Rekomandohet që të punohet për nxitjen e studimeve kërkimore të studentëve nga ky program studimi.</u></i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” garanton rritjen e aftësive zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale.</i></p> <p><i><u>Rekomandohet që të punohet për të nxitur zhvillimin e kompetencës kërkimore shkencore tek studentët.</u></i></p>

<sup>108</sup> 34. Marrveshje Bashkpunimi.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>109</sup> Evidenca 13b.Shkëmbimet Erasmus+.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>110</sup> Evidenca 13a. Linqet e Veprimtarive te Departamentit per Trajnime dhe Pedagoge te Ftuarë..pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Nga konsultimi me rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, rezulton se në nenin 16, pika 2, studimet përmbillen me provën finale që do të jetë në trajtën e provimit të përgjithshëm të formimit <sup>111</sup> .  <i>Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit MPMTIK, të merret në konsideratë përmbyllja e studimeve edhe në trajtën e punimit të një teme diplome.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se Departamenti harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit, të cilat u vihen në dispozicion studentëve. <sup>112</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurisë të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv u konstatua se provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike duke përfshirë lëndë në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.  Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në programin e provimit të formimit për diplomim. <sup>113</sup>

<sup>111</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf. Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>112</sup> Evidenca 2.4.Program per Provimin e Dipomimit e Programit TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>113</sup> Evidenca 2.4.Program per Provimin e Dipomimit e Programit TIK.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Mbështetur në shqyrtimin e rregullores së studimit është konstatuar se studentët e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informatik dhe Komunikimi i nënshtrohen provimit të formimit.</p> <p><i>Rekomandohet që të konsiderohet në rregulloren e programit të studimit MPMTIK, përmblyllja e studimeve edhe me punimin e temës së diplomës.</i></p> <p>Referuar bisedave me stafin akademik efektiv u konstatua se tezë kërkimi mund të zhvillojnë ata studentë që kanë mesatare mbi 9,5 me vendim senati.</p> <p><i>Rekomandohet që të rishikohet nota mesatare e vendosur për të realizuar tezë kërkimi, me qëllim mbështetjen e një numri më të lartë studentësh për të zhvilluar kompetencën kërkimore shkencore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Mbështetur në bisedat me stafin akademik efektiv referuar edhe programeve të tjera të studimit në departament, u konstatua se pedagogët i ndihmojnë studentët në rastin e temave kërkimore në lidhje me fushën e studimit.</p> <p><i>Ky program është në proces dhe ende nuk ka studentë që kanë kaluar procesin e provës finale të diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit MPMTIK Në Kreun II, nenin 16 <sup>114</sup> është specifikuar që studimet përmblyllen me provën finale që do të jetë në trajtën e provimit të përgjithshëm të formimit. Referuar takimit me stafin akademik efektivë dhe përgjegjës të departamentit u konstatua që ky provim do të vlerësohet me notë.</p> <p>Në programin e studimit të MPMTIK <sup>115</sup> është përcaktuar që prova finale ka 12 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti “Barleti” evidentohet se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. <sup>116</sup></p>

<sup>114</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf, Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>115</sup> Evidenca 2. I.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf, Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>116</sup> Evidenca shtese A. Diploma + Suplementi i Diplomes - MP. ne MNX.pdf, Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>

përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>Rekomandohet të rishikohet rregullore e programit të studimit MPMTIK në Kreun II, neni 16, pika 1 "Për të fituar Diplomën Master Profesional në Mësuesi në "Teknologji Informatike dhe Komunikimi" studentit duhet të ketë siguruar 96 kredite", ndërkohë që ky është master me 120 kredite.</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar takimit të zhvilluar në sekretarinë e programit të studimit u konstatua se në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për procesin mësimor të çdo viti akademik, që arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Në rastet kur studentit pas diplomimit kërkon, ai mund të pajiset me dublikata të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi në Teknologjinë e Informatikës dhe Komunikimit" dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të studimeve.</i>  <i>Rekomandohet që të merret në konsideratë në rregulloren e programit të studimit MPMTIK, përmbyllja e studimeve edhe në trajtën e punimit të një teme diplome.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.6

**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë	Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional garanton mjedise jashtë institucionit të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale. Institucioni ka krijuar dhjetëra marrëveshje me shkolla publike

<p>institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>dhe jopublike të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë për zhvillimin e praktikave profesionale.<sup>117</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Nga vizita e zhvilluar në institucion rezultoi se studentët e masterit profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi kanë akses të plotë që të zhvillojnë orët mësimore me qasje praktike në labororët e institucionit të cilat janë të pajisura me teknologjitë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se studenti është i detyruar të ndjekë praktikrat profesionale të parashikuara në planin mësimor të programit Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.</p> <p>Praktikat profesionale ekuivalentohen në 12 kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës me notë. Mendimi i trajnerëve dhe vlerësimin përkatës i praktikës mbështeten mbi Paketën e praktikës profesionale<sup>118</sup> e cila është e miratuar nga Senati Akademik i Universitetit “Barleti”.</p> <p><i>Rekomandohet që të konsiderohen në paketën e praktikës profesionale tregues/indikator që mbështetin përmbushjen e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit dhe profilit lëndor për të cilin studenti do të diplomohet.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kritereve 1-3 të standardit III.6, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se njësi përgjegjëse e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ndjek një procedurë të qartë të</i></p>

<sup>117</sup> Evidenca 22.4. Lista e Praktikave të Studentëve në Institucionet ku kanë zhvilluar Praktikën Profesionale.pdf Parë më Mars 2024 në <https://ascal.al/sq>

<sup>118</sup> Evidence shtesë 5. Paketa e praktikës profesionale.pdf. Parë më Prill 2024 në <https://ascal.al/sq>



	<p><i>zbatim të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike sipas profileve lëndore, si edhe nëpërmjet praktikës profesionale.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të konsiderohen në paketën e praktikës profesionale tregues/indikator që mbështesin përmbushjen e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit dhe profilit lëndor për të cilin studenti do të diplomohet.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## I. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” (MPMTIK) plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit MPMTIK është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS) <sup>119</sup> (Aneks-Tabela 1) gjatë vitit akademik 2022-2023 ka patur 36 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet: <b>1 Prof. Dr.; 4 Prof. As. Dr.; 12 Dr.; 19 MSc.</b>

<sup>119</sup> Evidenca 23. Te dhena tabelore per 3 vitet e fundit personelin akademik MPTIK Tabela 1 & 2.pdf

<p>në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>FSHSTS gjatë vitit akademik 2023-2024 ka 38 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet: <b>1 Prof. Dr.; 5 Prof. As. Dr.; 13 Dr.; 19 MSc;</b></p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit<sup>120</sup> (Aneks-Tabela 12.1 / 12.2) janë cilësuar edhe titullarët e lëndëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ 2022-2023 (2 Prof. As. Dr.; 3 Dr.)</li> <li>○ 2023-2024 (1 Prof. Dr.; 2 Prof. As. Dr.; 5 Dr./Phd)</li> </ul> <p>të cilët kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit MPMTIK.</p> <p>Referuar (tabelave 6.1 dhe 6.2, evidenca nr. 24)_stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për dy vite akademike është si më poshtë :</p> <table border="1" data-bbox="603 878 1436 1294"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> <th colspan="2">2023 - 2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Në total</b></td> <td><b>6</b></td> <td><b>0</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>0</b></td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	-	1	-	Prof.As.Dr	2	-	2	-	Dr/PhD	3	-	5	-	Msc	1	-	-	-	<b>Në total</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>
Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof. Dr	-	-	1	-																															
Prof.As.Dr	2	-	2	-																															
Dr/PhD	3	-	5	-																															
Msc	1	-	-	-																															
<b>Në total</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>0</b>																															
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se ngarkesa e personelit akademik<sup>121</sup>, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. DSHETP planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me punësimin e stafit të UniBa. Ngarkesa mësimore e personelit akademik është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.<sup>122</sup></p> <p>Programi i studimit MPMTIK është i mbuluar në masën 100% nga staf akademik efektiv i UniBa, kryesisht nga DSHETP dhe</p>																																		

<sup>120</sup> Aneks-Tabela 12-Plani mesimorë i lidhur me stafin akademik perkates.pdf

<sup>121</sup> Evidenca 25. Te dhena tabelore me ngarkesen akademike. MPTIK Tabela 4.pdf

<sup>122</sup> Evidenc Shtes 2.Udhezim per hartimin e ngarkeses mesimorë 2022-2023.pdf

	Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK). <sup>123</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga takimi me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore konstatohet se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në DSHETP ka një kontratë pune me afat të pacaktuar kur është i kategorisë lektor dhe profesor dhe me afat një vjeçar për kategorinë asistent-lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe statutit të UniBa <sup>124</sup> . Të dhënat e personelit akademik mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila krijon Dosjen Individuale <sup>125</sup> të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ku depozitohet i gjithë informacioni së bashku me kontratat e punës dhe sigurimet shoqërore dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rekrutimi i personelit akademik në FSHSTS - UniBa realizohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e institucionit <sup>126</sup> . UniBa garanton cilësinë e personelit akademik dhe zbaton procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura <sup>127</sup> sipas kritereve të përcaktuara nga Njësia Bazë. Për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve ngrihet një komision ad-hoc i cili vlerëson kandidatët në dy faza: përmes vlerësimit të dosjes dhe përmes intervistës. Procedura që ndjek UniBa është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit <sup>128,129</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton	Gjatë vizitës në institucion, u njohëm me laboratorët dhe me infrastrukturën laboratorike. Konstatohet se zhvillimi i seancave

<sup>123</sup> Aneks-Tabela 12-Plani mesimorë i lidhur me stafin akademik perketes.pdf

<sup>124</sup> Evidencë 1.1 Statuti UniBa (Neni 51-Personeli Akademik)

<sup>125</sup> Evidenca 7.1. Formatit i dosjes personale të stafit

<sup>126</sup> Evidencë 1.1 Statuti UniBa;

<sup>127</sup> <https://umb.edu.al/news5146.html>

<sup>128</sup> Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

<sup>129</sup> Evidenca 33. Kodi i Etikës.pdf

<p>angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>laboratorike mbështetet nga staf ndihmës akademik që nuk është pjesë e strukturës së FSHSTS<sup>130</sup>. Gjithashtu, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se FSHSTS ka në administrim të tij 3 laboratorë Informatike dhe 1 laborator për lëndët në Kampusin 2.<sup>131</sup></p> <p><i>Rekomandohet punësimi i personelit ndihmës akademik - laborant pranë FSHSTS (që ka një formim që përshtatet me natyrën specifike të programeve të studimit pranë fakultetit) me qëllim asistimin e orëve që zhvillohen në ambientin e laboratorit dhe kontribuimin në mirëmbajtjen e tij.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, certifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetësore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj.<sup>132</sup> Të dhënat e stafit efektiv<sup>133</sup> dhe atij me kontratë administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitë bazë për program studimi.</p> <p>Informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohet konform akteve rregullatore institucionale.<sup>134</sup> GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga UniBa dhe takimeve të zhvilluara konstaton korrektësi në zbatimin e procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se bashkëpunimet e UniBa me shkolla publike dhe jopublike, Qendra Private Digjitale të Zhvillimit të Fëmijëve dhe institucione të tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara.<sup>135</sup> FSHSTS mbështetet në këto marrëveshje bashkëpunimi për të përmbushur objektivat e</p>

<sup>130</sup> Evidenca 23. Te dhena tabelore per 3 vitet e fundit personelin akademik MPTIK Tabela 1 & 2.pdf

<sup>131</sup> Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën

<sup>132</sup> Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

<sup>133</sup> Evidenca 7.1. Formati i dosjes personale të stafit

<sup>134</sup> Evidenca 33. Kodi i Etikes.pdf

<sup>135</sup> 34. Marrveshje Bashkpunimi.pdf; 34.1 Marrveshje Bashkpunimi.pdf

<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>lëndëve praktike të planit mësimor. Këto marrëveshje përdoren edhe për realizim të praktikave profesionale të studentëve, të cilat janë pjesë e planit mësimor dhe zënë 12 kredite (ECTS).<sup>136</sup></p> <p>Gjatë takimit me stafin PAE që mbulon programin e studimit MPMTIK dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se 3-4 pedagogë janë udhëheqës të Praktikës Profesionale, por ngarkesa mësimore e kësaj lënde (270 orë) nuk është e shpërndarë dhe gjithashtu i mungon syllabusi.<sup>137</sup></p> <p>Gjithashtu, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet që ekziston një <i>Program për Provën Finale të MPMTIK</i><sup>138</sup>, por ka mungesë të një <i>Fondi Pyetjesh</i> në lidhje me të.</p> <p><i>Rekomandohet hartimi i syllabusit për lëndën Praktikë Profesionale si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore të kësaj lënde. Gjithashtu, hartimi i një Fondi Pyetjesh për Provën Finale bazuar edhe në Fondin e Pyetjeve të Provimit të Liçensimit.</i></p>
<p><b>Kriter 8. Personeli</b> mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Ky program studimi ka të parashikuar lëndën e "<i>Praktikës Profesionale</i>" që realizohet në vitin e dytë të studimeve MPMTIK, në përfundim të së cilës studenti fiton 12 kredite (ECTS). Praktika Profesionale realizohet si aktivitet i mbështetur në Marrëveshjet e Bashkëpunimit që UniBa ka me institucione publike apo private. Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës dhe një mbikëqyrës në institucionin pritës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve duke qenë i pranishëm në vlerësimin e Praktikës Profesionale.<sup>139</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit IV.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UniBa dëshmon njëtrajtshmëri të numrit të personelit akademik në dy vitet e fundit.</i></li> </ul>

<sup>136</sup> Evidenca shtese 4, Evid2.1.a. Plani mësimor MP. Mësuesi në TIK.pdf

<sup>137</sup> Aneks-Tabela 12-Plani mesimorë i lidhur me stafin akademik perkates.pdf; Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf

<sup>138</sup> Evidenca 13. Program per provimin e diplomimit e programit TIK.pdf

<sup>139</sup> Evidenca 2.3 UniBa\_Paketa e praktikës.pdf; Evidenca B.1 Guidë instruktive e student per plotesim paketen e praktikës.pdf

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Titullarët e lëndëve kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit MPMTIK.</i></li> <li>- <i>Programi i studimit MPMTIK është i mbuluar në masën 100% nga staf akademik efektiv i UniBa.</i></li> <li>- <i>Procedura që ndjek UniBa për rekrutimin e stafit akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</i></li> </ul> <p><u>Rekomandohet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>punësimi i personelit ndihmës akademik - laborant pranë FSHSTS me qëllim asistimin e orëve që zhvillohen në ambientin e laboratorit dhe kontribuimin në mirëmbajtjen e tij.</i></li> <li>- <i>hartimi i syllabusit për lëndën Praktikë Profesionale si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore të kësaj lënde. Gjithashtu, hartimi i një Fondi Pyetje për Provën Finale bazuar edhe në Fondin e Pyetjeve të Provimit të Liçensimit.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të	FSHSTS e shtrin aktivitetin e tij në dy Kampuse 1 & 2. Mjediset e brendshme të godinave sigurojnë salla leksioni, seminari, laboratorë, bibliotekë, zyra dhe mjedise për studentët. Aktiviteti mësimor për programin e studimit MPMTIK, zhvillohet në 3 laboratorë informatike, 2 salla leksioni, 5 salla seminari, 4 salla praktike lëndore/profesionale, 3 salla për bibliotekë, 20 salla interneti dhe 20 nyje hidrosanitare <sup>140</sup> . Nga vizita në ambientet ku zhvillon mësimin programi MPMTIK, konstatohet se godina

<sup>140</sup> Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën



programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	e FSHSTS është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion konstatohet se ambientet ku zhvillon mësim FSHSTS janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Konkretisht, FSHSTS zotëron 3 laboratorë, të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor (smartboard, sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video, videoprojektor dhe shërbim interneti, etj.) dhe një dhomë serverash. Çdo laborator është i pajisur me 20-25 poste pune të pajisura me PC me programe software të përshtatshme sipas planit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi IT i dedikuar për mirëmbajtjen teknike të secilit laborator. <sup>122</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	FSHSTS vë në dispozicion të programit të studimit MPMTIK 3 laboratorë dhe 1 sallë serveri. Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbulohen nga stafi akademik i programit të studimit MPMTIK. Secili laborator është i pajisur me 20-25 PC me parametra të përshtatshëm për të instaluar programet e nevojshme që aftësojnë studentët në fushën e mësuesisë në TIK. <sup>122</sup>  GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve të FSHSTS dhe u njoh nga afër me pajisjet teknike në mbështetje të mësimdhënies dhe praktikave profesionale.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në bazë të specifikës së programit të studimit MPMTIK, FSHSTS vë në shërbim të studentëve 3 laboratorë dhe një dhomë serveri të cilët janë të pajisur me software dhe hardware që mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik. Laboratorët janë të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron si dhe janë të aksesueshëm me internet dhe kanë në dispozicion edhe videoprojektor në kuadër të ilustrimit dhe shpjegimit për pedagogun dhe studentin.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që	Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se FSHSTS disponon dhe

<p>zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>zotëron të gjitha kapacitetet dhe mjediset e nevojshme për zhvillimin e praktikës jo vetëm brenda ambienteve që disponon, por e mundëson atë edhe në kuadër të partneritetit me shkolla publike dhe private<sup>141</sup> si dhe me zyra arsimore me qëllim që studentët të plotësojnë në maksimum prekjen e terrenit të tyre të punës duke e zhvilluar sa më të plotë e shumë profesionale praktikën, si brenda institucionit ashtu edhe në institucionet dhe njësitë partnere. FSHSTS disponon 4 salla praktike lëndore/profesionale<sup>122</sup> që vihen në shërbim të këtij procesi.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit IV.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Universiteti i Barleti vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në</p>	<p>Literatura e bazë e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip). Në rastin kur nuk ka një botim me ISBN në gjuhën shqipe për lëndën atëherë si literaturë bazë shërben një</p>

<sup>141</sup> 34. Marrveshje Bashkpunimi.pdf; 34.1 Marrveshje Bashkpunimi.pdf





<p>gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>cikël leksionesh nga titullari dhe lektorët e lëndës. Literatura bazë, përgjithësisht, është e evidentuar qartë në syllabusin e lëndës dhe i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës dhe/ose në format fizik në bibliotekën e UniBa. Literatura ndihmëse është kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht).<sup>142</sup> Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara suplementare për këtë program studimi.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se literatura bazë/rekomanduar nuk është e viteve të fundit dhe <i>rekomandohet që t'i kushtohet më shumë kujdes përzgjedhjes së saj me autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe të përfshihet në fondin e Bibliotekës.</i><sup>143</sup></p> <p>Gjithashtu, konstatohet që literatura bazë në disa module të lëndëve “Kurrikul e TIK” dhe “Didaktikë e TIK” është e njëjtë dhe <i>rekomandohet që në lëndën “Didaktikë e TIK” kjo literaturë të ketë orientim didaktik me qëllim plotësimin e objektivit kryesor që ka vetë programi i studimit MPMTIK.</i></p> <p><i>Konkretisht: literatura bazë e modulit “Bazë të Dhënash” në lëndën “Kurrikul e TIK” është e njëjtë me literaturën bazë të modulit “Bazë të Dhënash” në lëndën “Didaktikë e TIK”.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se në listën e teksteve/periodikëve që ofrohen në Bibliotekën e UniBa, në funksion të programit të studimit<sup>125</sup>, ka kryesisht tekste të fokusuar në fushën e edukimit dhe psikologjisë. Gjithashtu konstatohet se mungon një evidencë për “<i>Kërkesë tituj librash nga DSHEPT në funksion të këtij programi studimi</i>”.</p> <p><i>Rekomandohet që “Lista e teksteve/periodikëve që ofrohen në Bibliotekën e UniBa në funksion të programit të studimit” të pasurohet me literaturë, vendase dhe të huaj, të viteve të fundit të fushës së TIK, në mënyrë që të ketë lidhje me literaturën që referohet në syllabuse.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin Barleti, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve e studiuesve.</p>

<sup>142</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf

<sup>143</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve-periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.pdf

<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me raftë librash me kapacitet të madh mbajtës dhe ka në fondin e saj 9137 libra në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. FSHSTS ka në dispozicion të tij 3 salla për bibliotekë me sipërfaqe në total 150.80 m<sup>2</sup>.<sup>144</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare ofron literaturë, tekste mësimore dhe plotësuese që mbështesin kurrikulat mësimore. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik. Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të aksesueshme nga studentet dhe pedagogët. Në shërbim të programit të studimit MPMTIK janë 244 njësi bibliotekare, 16 e-Books, 12 Revista shkencore si dhe platforma Biblioteka on-line.<sup>145,146</sup></p> <p>Konstatohet se dokumentacioni që reflekton “Listën e titujve konform specifikave të programit” është e pa azhurnuar dhe <u>sugjerohet pasurimi i saj me literaturë të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se studentët kanë mundësi dhe u ofrohet lehtësi për akses falas të librave me anë të sistemit të menaxhimit të Bibliotekës on-line. Ata kanë mundësi të kërkojnë librin dhe të kontrollojnë nëse një kopje fizike e tij është gjendje ose të bëjnë rezervimin e tij në momentin kur libri të jetë gjendje në bibliotekë.<sup>128</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se platforma e Bibliotekës on-line<sup>147</sup> dhe mënyra se si ajo është konceptuar nga ana infrastrukturore, i mundëson studentëve të përdorin maksimalisht benefitet e aksesimit të fondit të librave nëpërmjet kompjuterave që ndodhen në sallat e bibliotekës ose nëpërmjet</p>

<sup>144</sup> Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën

<sup>145</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve-periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.pdf

<sup>146</sup> Evidenca 30.a Te dhenat per platformen online Biblioteka.pdf; Evidenca 30.c. Platforma e bibliotekës online.pdf

<sup>147</sup> <https://umb.edu.al/biblioteka.html>

	aplikacioneve celulare që aksesohen përmes llogarive falas që ka çdo student i UniBa. <sup>128,148</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se biblioteka ishte në dispozicion të stafit dhe studentëve çdo ditë nga ora 09.00-20.00, duke iu përgjigjur nevojave të stafit dhe studentëve për ta aksesuar atë. Biblioteka kishte një përgjegjës të angazhuar me menaxhimin dhe koordinimin fizik dhe digjital të saj. Oraret e zgjatura lehtësonin frekuentimin e bibliotekës, sipas mundësive që kishin studentët pa i kufizuar ata në kohë duke plotësuar maksimalisht kërkesat për kapacitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur çdo studentit të interesuar për të tërhequr dhe lexuar libër, apo për të hulumtuar literaturën e nevojshme.
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se mungon një evidencë për “Kerkese titujsh dhe librash nga DSHEPT” si në listën e evidencave të dorëzuara në fazën fillestare të aplikimit ashtu edhe në listën e evidencave shtesë të kërkuara nga GVJ pas vizitës në UniBa.  Gjatë vizitës në institucion vlerësohet puna e Bibliotekës së UniBa si një njësi në shërbim jo vetëm të universitetit por të të gjithë komunitetit, por nuk mund të gjykohej në lidhje me shkallën e shfrytëzimit të infrastrukturës fizike dhe fondit të saj pasi GVB nuk ka paraqitur evidencë për këtë. <sup>149</sup>
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit IV.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Biblioteka u përgjigjet nevojave të</i>

<sup>148</sup> RVB TIK.pdf

<sup>149</sup> RVB TIK.pdf

	<p>programeve të studimit me staf të kualifikuar, ambiente infrastrukurore moderne dhe fond ekzistues fizik dhe elektronik.</p> <p><u>Rekomandohet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i kushtohet më shumë kujdes literaturës bazë/rekomanduar duke përzgjedhur autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe të përfshihet në fondin e Bibliotekës.</li> <li>- literatura bazë në lëndën "Didaktikë e TIK" të ketë orientim didaktik me qëllim plotësimin e objektivit kryesor që ka vetë programi i studimit MPMTIK</li> <li>- "Lista e teksteve/periodikëve që ofrohen në Bibliotekën e UniBa në funksion të programit të studimit" të pasurohet me literaturë, vendase dhe të huaj, të viteve të fundit të fushës së TIK.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit<sup>151</sup> të vënë në dispozicion konstatohet se institucioni disponon një sistem menaxhimi<sup>150</sup> nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre lidhur me sezonin e provimeve, vlerësimet, pagesat etj. UniBa vë në dispozicion <i>Portalin Studentor</i><sup>151</sup> të cilin studentët e aksesojnë në faqen zyrtare të UniBa <a href="https://studentportal.umb.edu.al/">https://studentportal.umb.edu.al/</a> me anë të një përdoruesi i cili identifikohet me një email dhe një fjalëkalim.</p> <p><u>Sugjerohet</u> që UniBa të sigurojë një sistem menaxhimi elektronik të integruar pedagog-student-sekretari mësimore me anë të të cilit të realizojë: grafikun e provimeve, komisionet e provimeve, frekuentimin e studentëve, vlerësimin e studentëve, gjenerimin e</p>

<sup>150</sup> Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Struktues së Teknologjise së Informacionit.pdf

<sup>151</sup> Evidence Shtese 10. (46.)Portali Studentor UMB Sistemi elektronik Menaxh Aktiv.pdf

	<i>proces-verbaleve të notave, tarifave shkollore, librezën studentore, regjistrimin në modulet e lëndëve, riprovime, gjenerimin e raportimeve në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare etj.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se komunikimi në UniBa mundësohet nëpërmjet rrjetit privat të brendshëm “Shared” Intranet <u>shared on '192.168.1.3'</u> . <sup>152</sup> Nëpërmjet tij ndahen në mënyrë të sigurtë informacionet e universitetit dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione. Intraneti i mundëson punojësit të aksesojë informacione të rëndësishme, linqe, aplikacione, forma dhe të dhëna të tjera nga rekorde të databazës së UniBa. <sup>153</sup> Hapja e llogarive në Intranet realizohet nga zyra e TIK nën menaxhimin e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Roli dhe lloji i përdoruesit përcaktohet në bazë të pozicionit të punës që ka duke qartësuar edhe dosjet dhe dokumentet në të cilat ai ka të drjetë të aksesojë me qëllim realizimin e proceseve të tilla si: përgatitja dhe monitorimi i orareve mësimore, kontratat e punës, formularët e matjes dhe vlerësimit të performancës, formularët dhe programi i ngarkesës mësimore, formulari i evidentimit të masave disiplinore dhe aplikimit për leje vjetore, raporte leje lindje etj.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit, duke marrë parasysh <i>Intranetin</i> për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe <i>Portalin Studentor</i> për studentët, funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë vetjake/private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UniBa <sup>154</sup> duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FSHSTS. Të dhënat janë të ruajtura dhe mund të aksesohen për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FSHSTS.

<sup>152</sup> Evidenca 57 Manual perdorimi Intranet.pdf

<sup>153</sup> Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Struktures se Teknologjise se Informacionit.pdf

<sup>154</sup> www.umb.edu.al

<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se në UniBa komunikimi ndërveprues dhe shkëmbimi i informacionit të brendshëm realizohet me anë të sistemit elektronik të komunikimit, me anë të emaileve në grup me domain-in umb.edu.al, me anë të klasave në ‘Google Classroom’ sipas lëndëve, grupeve, viteve dhe programeve të studimit, me anë të komunikimit në ‘Google Meet’<sup>135</sup> si dhe me anë të grupeve në rrjete sociale dhe në platformat dhe aplikacionet e komunikimit Whatsapp. Ky komunikim realizohet edhe në kontaktet individuale të personalizuara të pedagogut dhe studentëve, sekretarisë apo koordinatorëve të programeve me studentët, në auditor etj.<sup>155</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemet e menaxhimit përgjithësisht konfigurohen për të gjeneruar raporte të ndryshme në funksion të funksionaliteve për të cilat janë ndërtuar. E megjithatë GVJ nuk është në gjendje të gjykojë në lidhje me garantimin e një monitorimi në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësimin të raportimeve individuale dhe të dhënave në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese duke qenë se GVB nuk ka vënë në dispozicion një evidencë të tillë.<sup>137</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UniBa [<a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a>] merret informacion në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në faqe gjenden informacione të detajuara në lidhje me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e UniBa. Përtej faqes web, UniBa përdor edhe rrjete sociale si Facebook, Instagram, YoutUniBa, Twitter: Universiteti Barleti, Trajnime Barleti, Klubet Studentore Barleti [<a href="http://www.ieb.edu.al">www.ieb.edu.al</a>; <a href="http://www.bttc.edu.al">www.bttc.edu.al</a>] ku publikon njoftime dhe foto të aktiviteve, mundësi praktikash mësimore, bashkëpunime, mobilitete, etj.<sup>138</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit IV.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa disponon sistem të menaxhimit: Intranetin për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe Portalin Studentor për studentët me qëllim administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>

<sup>155</sup> RVB TIK.pdf

	<i>Sugjerohet që UniBa të sigurojë një sistem menaxhimi elektronik të integruar pedagog-student-sekretari mësimore me anë të të cilit të realizojë: grafikun e provimeve, komisionet e provimeve, frekuentimin e studentëve, vlerësimin e studentëve, gjenerimin e proces-verbaleve të notave, tarifat shkollore, librezën studentore, regjistrimin në module, riprovime, gjenerimin e raportimeve në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare etj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa tregon një stabilitet financiar dhe monitorim rigoroz të të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në historikun e kostove, raportin tarifë-shpenzime <sup>156</sup> si dhe në parashikimin e fondit rezervë emergjent për sigurimin e mbarëvajtjes për një cikël të plotë studimi. <sup>157</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa administron me përgjegjshmëri dhe korrektësi të gjitha pikat e planit të financimit referuar jo vetëm ecurisë së mbarëvajtjes së institucionit dhe programit të studimit, por edhe përmbushjes në kohë të të gjitha detyrimeve kontraktuale që janë burim i marrëveshje dhe kontratave që UniBa ka nënshkruar me të tretë <sup>158</sup> .

<sup>156</sup> Evidenca 39 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional.pdf; Evidenca 40. Te dhena nga Raporti Finac i Program TIK.pdf

<sup>157</sup> Evidenca 40.a. Burimet Financiare UniBa.pdf; Evidenca 40.c. Burimet Financiare UniBa.pdf

<sup>158</sup> Evidenca 39 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional.pdf; Evidenca 40. Te dhena nga Raporti Finac i Program TIK.pdf

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa, konkretisht auditimi dhe financa merren me administrimin e të gjithë zërave, që kategorizohen në të ardhura dhe shpenzime, duke patur në fokus ofrimin e një stabiliteti afatgjatë të të ardhurave me anë të sistemimit dhe korrigjimit me seriozitet të kostove<sup>140</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se institucioni ka në fokus të tij hartimin e raporteve financiare<sup>140</sup> për dy vitet e fundit akademike me qëllim evidentimin e nevojave, parashikimin e ecurisë dhe planifikimet e mundshme të ndërhyrjes për përmirësimin dhe rritjen e standardeve të programit të studimit në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Financës ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UniBa. UniBa rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht tarifat e studentëve si dhe të ardhura të tjera nga projekte dhe donacione) për të realizuar objektivat e tij. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë në këtë program studimi paraqet qëndrueshmëri rritje (4 studente/vitiII, 9 studentë/vitiI), duke kontribuar edhe nëpërmjet tarifave për dhe gjatë shkollimit. Sipas analizës financiare të institucionit, për vitet 2023-2024 prashikohet rritje e e fitimit.<sup>159</sup></p> <p><i>Rekomandohet që UniBa të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit IV.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij. Rekomandohet që UniBa të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të</i></p>

<sup>159</sup> Evidenca 39 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional.pdf; Evidenca 40. Te dhëna nga Raporti Financ i Program TIK.pdf





	<i>ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin MPMTIK. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i UniBa<sup>160</sup>, Rregullore e UniBa<sup>161</sup>, Rregullore e FSHSTS<sup>162</sup> dhe Rregullore e MPMTIK<sup>163</sup> përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre.</p> <p>Statuti UniBa, Neni 4 thekson se ka për Mision të përgatisë studentë profesionistë novatore, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat dhe ndryshimet në vazhdim. Rregullore e UniBa e ka studentin si shtyllë qendrore ndër 5 shtyllat e aktiviteteve</p>

<sup>160</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>161</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf

<sup>162</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf

<sup>163</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf



kryesore të UniBa. Njësitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në kuadër të kësaj shtylle dhe në varësi të Zv. Rektori për Çështjet Studentore dhe Komunitetin janë: Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve dhe Zyra e Alumni dhe Karriera. Hartimi i dokumenteve bazë institucionale gjehet në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019, por konstatohet se në Rregulloren e DSHETP<sup>164</sup> ka mungesë të neneve në lidhje me politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Gjithashtu, konstatohet se në Rregulloren e programit të studimit MPMTIK duhen rishikuar dhe detajuar konform Nenit 66 të Statutit të UniBa:

- Neni 2 - Përshkrimi i programit dhe objekti (pika 4 duhet formuluar specifikisht për programin MPMTIK)
- Neni 16 - Prova Finale (rishikuar nr. i krediteve)
- Neni 18 - E drejta për të hyrë në provim (nuk parashikohet se cili do të jetë vlerësimi i studentit kur ai regjistrohet për përmirësim dhe nuk paraqitet në provim)
- Neni 20 - Komunikimi i Vlerësimeve (të detajohet se kush klasifikohet si lëndë e veçantë)
- Neni 24 - Kriteret e Pranimit (të detajohen fushat përkatëse të programeve bachelor që mund të plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e këtij programi studimi)
- ANEKSI II - Mundësitë e Punësimit (mungojnë për MPMTIK, rezultojnë të MP “Mësimdhënia dhe të Nxënërit”)

*Rekomandohet hartimi i neneve në lidhje me politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në Rregulloren e DSHETP si dhe rishikimi dhe detajimi i disa neneve të Rregullores së Programit të Studimit MPMTIK bazuar në procedurat dhe nenet e Statutit dhe të Rregullores së UniBa të miratuara nga Senati Akademik i UniBa.*

<sup>164</sup> Evidenca I.3. Rregullore e Departamenti të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP).pdf



<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet zbatimi i procedurave që garantojnë barazi për çdo student. Procedurat dhe kriteret specifike bëhen publike<sup>165</sup> sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të UniBa<sup>166</sup>. Rregullorja e UniBa<sup>167</sup> përmban procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton procedura transparente dhe trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve. Dokumentet institucionale<sup>168</sup> përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar lirinë përkatëse të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se DSHETP propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor, miratimi i të cilit bëhet nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe vijon me MASR. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa<sup>169</sup> si edhe në portalin U-Albania. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion<sup>170</sup>, nga lista e evidencave shtesë<sup>171</sup> të kërkuara pas vizitës në UniBa si dhe nga faqja web e IAL, konstatohet se procedura e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të UniBa, por i vetmi kriter që UniBa vendos për pranim në MPMTIK është ai i notës mesatare i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p><i>Rekomandohet që kriteret hyrëse të specifikohen më tej më përcaktimin e fushave të ciklit të parë të studimit që studenti duhet të ketë pjesë të formimit të tij në mënyrë që t'i jepet mundësia të ndjekë MPMTIK dhe të plotësojë objektivat e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve,</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik konstatohet se FSHSTS vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve,</p>

<sup>165</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-mesuesi-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikim.html>

<sup>166</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>167</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf

<sup>168</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf

<sup>169</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-mesuesi-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikim.html>

<sup>170</sup> Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2021-2022.pdf

<sup>171</sup> Evidenca shtesë 3.Kriteret e pranimit 2022-2023.pdf

<p>përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e UniBa: Satutin e UniBa<sup>172</sup>, Rregulloren e UniBa<sup>173</sup>, Rregulloren për Transferimin e Studentëve<sup>174</sup> dhe në Rregulloren e MPMTIK<sup>175</sup>. Këto rregullore janë në dispozicion të të gjithë të interesuarve brenda dhe jashtë institucionit përveç Rregullores për Transferimin e Studentëve.</p> <p><i>Rekomandohet që çdo rregullore institucionale që ka lidhje me studentin të jetë publike dhe e aksesueshme në faqen zyrtare online të UniBa.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion<sup>176</sup> konstatohet se politikat e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit të studentëve në programin e studimit hartohen çdo vit përpara fillimit të vitit akademik dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin U-Albania. Kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit kanë disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UniBa. Në faqen zyrtare web të këtij institucioni, në rubrikën “Pranimet”<sup>177</sup> ka informacion të mjaftueshëm i cili mund edhe të zgjerohet me anë të kontakteve që janë të afishuara aty. Për secilin prej programeve të studimit që UniBa ofron ka informacion në lidhje me: përshkrimin e programit, planin mësimorë, kriteret e pranimit, mundësitë e punësimit, dokumentacionin për aplikim të ilustruar me anë të një broshure që mund të shkarkohet nga ana e studentëve. Gjithashtu, studentët e ardhshëm mund të informohen edhe gjatë ditëve të hapura që organizohen pranë ambienteve të UniBa.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa nuk aplikon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.<sup>178</sup> Gjithashtu, konstatohet se në faqen web të</p>

<sup>172</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>173</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf

<sup>174</sup> Evidenca 39.a. Rregullore për transferim të studenteve.pdf

<sup>175</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMTIK.pdf

<sup>176</sup> RVB TIK.pdf

<sup>177</sup> <https://umb.edu.al/pranimet.html>

<sup>178</sup> Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2021-2022.pdf

<p>veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UniBa<sup>179</sup> dhe në evidencën shtesë të kërkuar për kuotat e pranimit<sup>180</sup> për këto kategori nuk ka informacion në bazë të të cilit të bëhet një vlerësim. Kriteret pranuese dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare, në rrjetet sociale të UniBa si edhe në portalin U-Albania.</p> <p><i>Rekomandohet hartimi i kuotave të veçanta të pranimit për programin e studimit, bazuar në kapacitetet akademike dhe infrastruksturore që disponon FSHSTS, me qëllim mbështetjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa nuk aplikon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.<sup>160</sup> Gjithashtu, konstatohet se në faqen web të UniBa<sup>161</sup> dhe në evidencën shtesë të kërkuar për kuotat e pranimit<sup>162</sup> për këtë kategori nuk ka informacion në bazë të të cilit të bëhet një vlerësim. Duke qenë se programi i studimit ofrohet vetëm në gjuhën Shqipe, ky kriter i referohet kandidatëve nga trojet. Kriteret pranuese dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare, në rrjetet sociale të UniBa si edhe në portalin U-Albania.</p> <p><i>Rekomandohet hartimi i kuotave të veçanta të pranimit për programin e studimit, bazuar në kapacitetet akademike dhe infrastruksturore që disponon FSHSTS, me qëllim mbështetjen e kandidatëve nga shtete të tjera(trojet).</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UniBa<sup>181</sup> si dhe në faqen zyrtare të web<sup>182</sup>, konstatohet që institucioni parashikon aplikimin e bursave të ekselencës, meritës, bursa sociale dhe bursa promovimi për maturantë me mesatare mbi 9. Vlerësimi i këtyre bursave bëhet nga një komision <i>ad hoc</i> i ngritur nga Administratori i UniBa dhe miratohet përfundimisht nga Bordi i administrimit të UniBa.<sup>183</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit V.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa harton, ndjek dhe zbaton</i></p>

<sup>179</sup> <https://umb.edu.al/pranimet.html>

<sup>180</sup> Evidencë shtesë 9. Kuotat e pranimit romë, troje.,pdf

<sup>181</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf

<sup>182</sup> <https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html>

<sup>183</sup> RVB TIK.pdf

	<p><i>politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale.</i></p> <p><u>Rekomandohet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>hartimi i neneve në lidhje me politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në Rregulloren e DSHETP si dhe rishikimi dhe detajimi i disa neneve të Rregullores së Programit të Studimit MPMTIK bazuar në procedurat dhe nenet e Statutit dhe të Rregullores së UniBa të miratuara nga Senati Akademik i UniBa.</i></li> <li>- <i>kriteret hyrëse në programin e studimit MPMTIK të specifikohen më tej më përcaktimin e fushave të ciklit të parë të studimit që studenti duhet të ketë pjesë të formimit të tij në mënyrë që t'i jepet mundësia të ndjekë MPMTIK dhe të plotësojë objektivat e programit të studimit.</i></li> <li>- <i>çdo rregullore institucionale që ka lidhje me studentin të jetë publike dhe e aksesueshme në faqen zyrtare online të UniBa.</i></li> <li>- <i>hartimi i kuotave të veçanta të pranimit për programin e studimit, bazuar në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore që disponon FSHSTS, me qëllim mbështetjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara dhe të trojeve.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik konstatohet se FSHSTS vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Përgjegjësi i departamentit dhe çdo staf akademik i angazhuar në këtë program i informon studentët për kriteret e përparimit akademik për lëndët që ai mbulon. Informacioni në lidhje me përparimin akademik të studentëve gjendet edhe në rregulloret e institucionit.</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve në Kreu VII-Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijes të Rregullores së UniBa<sup>184</sup>, Kreu III - Vlerësimi i Studentit në Rregulloren e MPMTIK.<sup>185</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UniBa ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor edhe përmes sekretarisë mësimore duke u njoftuar për lëndët, regjistrimin përkatës, grupet dhe rezultatet e provimeve.</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi e lëndëve në Nenin 61 të Statutit të UniBa<sup>186</sup>, në Nenin 82 të Rregullores së UniBa<sup>166</sup>, në Rregulloren për Transferim të Studentëve<sup>187</sup> dhe në Manualin Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.<sup>188</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga drejtuesit e departamenteve të cilët mbajnë kontakte të vazhdueshme përgjatë vitit akademik me ta. Informacioni hard-copy (guida, rregullore të posaçme, fletëpalosje, procedura, etj.) është në dispozicion të studentëve në ambientet e FSHSTS.</p> <p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të</p>

<sup>184</sup> Evidenca 1.2 -Rregullore e UniBa.pdf

<sup>185</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf

<sup>186</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>187</sup> Evidenca 39.a. Rregullore per transferim te studenteve.pdf

<sup>188</sup> Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.pdf

	<p>dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij dhe rregullat e avancimit akademik. Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe forma e kontrollit të dijeve është pjesë e përgjegjësisë dhe lirisë akademike të titullarit të lëndës.<sup>189</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, konstatohet se ata ishin të informuar mbi procedurat e punimit të Temës së Diplomës dhe /ose Provimit të Formimit. Referuar RVB MPMTIK<sup>190</sup>, <i>Prova Finale zhvillohet në trajtën e Provimit të Formimit ose me Punim Diplome nqs studentët plotësojnë kushtin e mesatares mbi 9.5.</i> Kjo është konform Statutit UniBa (Neni 47, pika 6)<sup>191</sup> ku <i>diplomimi i studentëve realizohet me Provim Formimi ose me Punim Diplome</i> dhe në kundërshtim me Rregullore e FSHSTS (Neni 16, pika 3)<sup>192</sup> dhe Rregullore MPMTIK (Neni 16, pika 2)<sup>193</sup> ku thuhet se <i>Prova Finale përmbillet me Provim Formimi.</i></p> <p>Programi i miratuar i Provimit të Formimit<sup>194</sup>, u bëhet i njohur studentëve në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve. GVJ ka mungesë dokumentacioni në lidhje me <i>Fondin e pyetjeve për Provim Formimi MPMTIK</i> si dhe <i>Paketën e Provës Finale.</i></p> <p><u>Rekomandohet</u> që të bëhen ndryshimet e duhura në rregulloret përkatëse në lidhje me përcaktimin se cila do të jetë forma e realizimit të Provës Finale në përmblyllje të studimeve në programin e studimit MPMTIK.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për</p>	<p>Në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, konstatohet se ata kishin pasur disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit dhe mundësive që ofrohen në UniBa<sup>195</sup>, si psh: guida, ditët e hapura për maturantët, rregullore të posaçme, fletëpalosje, procedura, panairi Work and Study, guida e studentit, web site<sup>196</sup>, rrjete sociale, broshura si dhe strategjitë e rekrutimit dhe</p>

<sup>189</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf

<sup>190</sup> RVB TIK.pdf

<sup>191</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>192</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf

<sup>193</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPTIK.pdf

<sup>194</sup> Evidenca 13. Program per provimin e dipomimit e programit TIK.pdf

<sup>195</sup> Evidenca 49. Axhenda e Javes Orientuese.pdf; Evidenca 49. Axhenda, dita e pare e vitit akademik 2023-2024.doc

<sup>196</sup> <https://umb.edu.al/pranimet.html>



informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	marketingut. <sup>197</sup> Aty përfshihen konferenca me maturantët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze dhe jo vetëm, ekskursion/tours të maturantëve në mjediset e institucionit, vizita të stafit të UniBa në shkollat e mesme duke prezantuar me detaje kriteret e pranimit në secilin program studimi, konkurset, bursat, etj			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit V.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa sipas rregulloreve të tij institucionale disponon informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve. Koordinator i programit të studimit kryen takime informuese me studentët në fillim të vitit akademik dhe më pas mban kontakte dhe kryen takime periodike me studentët përgjatë vitit akademik.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të bëhen ndryshimet e duhura në rregulloret përkatëse në lidhje me përcaktimin se cila do të jetë forma e realizimit të Provës Finale në përmblyllje të studimeve në programin e studimit MPMTIK.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, konstatohet se ata ishin të mirëinformuar në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programin të studimit me anë të takimeve informuese, sqaruese dhe orientuese që realizohen në ditët e para të pritjes në UniBa, gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së parë të akomodimit <sup>198</sup> nga Dekani i Fakultetit apo Përgjegjësi i Departamentit, gjatë viteve të studimeve nga Koordinator i Departamentit, nga materiale informuese,

<sup>197</sup> Evidenca 41. Strategjia e marketingut.pdf

<sup>198</sup> Evidenca 49. Axhenda e Javes Orientuese.pdf; Evidenca 49. Axhenda, dita e pare e vitit akademik 2023-2024.doc

	sqaruese dhe ndërgjegjësuere, si: fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe materiale audio-vizive, si: spote televizive, mesazhe promovionale të vendosura në hollin e institucionit, nga faqja zyrtare e UniBa <sup>199</sup> si dhe nga informacionet që marrin nga klubet dhe rrjetet studentore të UniBa ku ata bëjnë pjesë. <sup>200</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrën e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plan programi i lëndës. <sup>201</sup> Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij private të manaxhimit të ciklit akademik, <i>Portali Studentor</i> . <sup>202</sup> Gjithashtu, studenti ka mundësi të informohet në lidhje me udhëzuesit, lëndët dhe veprimtaritë formuese në ambientet e sekretarisë mësimore, ndërsa vendimet që lidhen me studentët të marra nga Senati, Bordi i Administrimit, Rektorati apo Dekanati u komunikohen studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta nga Koordinatori i Departamentit apo faqja zyrtare e UniBa. <sup>181</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Alumnit dhe Karrierës <sup>203</sup> e cila funksionon në nivel institucional ofron në mënyrë të vazhdueshme për studentët: informacion dhe trajnim mbi situatën në tregun e punës, mundësi për zhvillimin e kompetencave, dhe lidhjen me bizneset në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti. Për të prezantuar studentët me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim, Zyra Alumni dhe Karrierës zhvillon bashkë me studentët aktualë dhe të diplomuar në UniBa, intervista pune, testime, orientim dhe këshillim nga ekspertë karriere, mbështetje në zhvillimin e aftësive karizmatike dhe atyre të lidhshme, mbështetje në zhvillimin e aftësive të së folurës në publik etj. <sup>204</sup> Të dhëna të përditësuara dhe njoftime punësimi për studentët gjenden në faqen zyrtare të UniBa dhe në Zyrën e Alumni dhe Karrierës. <sup>205</sup> Funksionimi i Zyrës Alumni dhe Karrierës është i rregulluar në nivel institucional

<sup>199</sup> <https://umb.edu.al/>

<sup>200</sup> <http://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html>

<sup>201</sup> Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset).pdf

<sup>202</sup> <https://studentportal.umb.edu.al/>

<sup>203</sup> Evidenc Shtes 6. Zyra Alumni.pdf

<sup>204</sup> Aktivitet mbi punësimin e studentëve në Bashkinë Tiranë; <http://www.umb.edu.al/news1312.html>;

<https://www.umb.edu.al/news1261.html>; <https://www.umb.edu.al/news4856.html>

<sup>205</sup> Evidenca 44. Tabela 3. punesimi real i studenteve.pdf

	nëpërmjet rregullore së kësaj njësie. <sup>206</sup> Studentët e MPMTIK janë të punësuar në sektorin privat dhe si mësues.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<i>Portali Studentor</i> u mundëson studentëve të UniBa informacion të përditësuar për të gjithë mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ambienteve në të cilat zhvillohet mësimi. Megjithatë një rol thelbësor luajnë edhe Koordinatori i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore e cila vë në dijeni studentët për çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij nëpërmjet email-it zyrtar. Në takimin me studentët, gjatë vizitës në institucion, konstatohet se ata ishin të mirëinformuar dhe kishin kontakte me secilin prej faktorëve të përmendur më lart.
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se studentët e UniBa kanë mundësi të aksesojnë të gjithë programet lëndore (syllabuset) përmes platformës Google Classroom, <sup>207</sup> ku çdo student sheh gjithë materialet sipas javëve dhe temave përkatëse. Gjithashtu, informacioni i detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. studentëve iu mundësohet përmes faqes së internetit të UniBa.  <i>Sugjerohet që UniBa të ofrojë një sistem të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit pedagog-student-sekretari mësimore që të ofrojë informacion në lidhje me programin e studimit dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga studentët edhe në distancë. Si dhe akses i informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit të jetë i kufizuar sipas të drejtave të përdoruesve dhe studentët të logohen me kredencialet e tyre në sistemin online.</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit V.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se stafi akademik ofron për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Sugjerohet që UniBa të ofrojë një sistem të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit pedagog-student-sekretari mësimore.</i>

<sup>206</sup> Evidenca 28. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve- shtylla II.pdf

<sup>207</sup> Evidenca 38 g Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa mban të dhëna statistikore vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve. Të gjitha këto të dhëna disponohen nga Sekretaria Mësimore <sup>208</sup> e FSHSTS e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe i përcjell ato tek drejtuesit e departamenteve dhe në Zyrën e Alumni dhe Karrierës. Duke qenë se MPMTIK është në vitin e tij të dytë dhe ende nuk është diplomuar brezi i parë, UniBa ka të dhëna në lidhje me numrin e studentëve dhe mesataren e tyre në hyrje. (Tabela 21 & Tabela 23) <sup>209</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në Sekretarinë Mësimore. Nga vizita në Sekretarinë Mësimore, e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve <sup>190</sup> , dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 2 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon <sup>191</sup> :  Viti akademik 2022-2023      4 studentë; Viti akademik 2023-2024      13 studentë;  Sekretaria Mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe tërheqja e saj me suplementin e

<sup>208</sup> Evidenca 19.1. Rregullore e Sekretarisë mësimore.pdf

<sup>209</sup> Evidenca 23. Te dhena tabelore per 3 vitet e fundit personelin akademik MPMTIK Tabela 1 & 2.pdf; Aneks-Tabela 21-Te dhena te plota per regjistrimin e studenteve, diplomimin.pdf

	diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar.
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet nga Sekretaria Mësimore. Studenti informohet për të dhënat e tij përmes <i>Portalit Studentor</i> i cili i mundëson akses në kohë reale, konfidencialitet dhe siguri. Bazuar në rregulloret institucionale si dhe në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, <sup>190</sup> këto të dhëna përpunohen nga sekretarja dhe u vihen në dispozicion sipas kërkesës Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit të FSHSTS.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Kontrolli periodik i përvitshëm për dokumentimin e saktësisë së informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse është një procedurë e sanksionuar në Rregulloren e Njësive të Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC). <sup>210</sup> NJBSC përbëhet nga drejtuesi dhe tre koordinatorë. <sup>211,212</sup> Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KSSC) i cili përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët një student. <sup>213</sup> Bazuar në Rregulloren e FSHSTS, <sup>214</sup> në nivel Njësie Kryesore, Dekani organizon dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet dhe fakulteti, ndërsa në nivel Njësie Bazë Përgjegjësi i Departamentit ushtron kontrolle për realizimin dhe cilësinë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor. <sup>215</sup> Gjithashtu Sekretaria Mësimore mban përgjegjësi administrative për saktësinë e dokumentave të hartuara e të lëshuara që i përcillen për firmë instancave më të larta.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre,	Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Njësia Bazë realizon një Analizë Vjetore <sup>216</sup> të punës në të cilën i kushton vemendje edhe cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje si dhe punësimit që ato aktualisht kanë dhe do të kenë pas diplomimit. <sup>217</sup> Aktualisht studentët e MPMTIK punojnë si mësues ose në sektorin privat.

<sup>210</sup> Evidenca 48. Plan i punës i NjZHKC.pdf

<sup>211</sup> Aneks-Tabela 24.pdf

<sup>212</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKSC).pdf

<sup>213</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf

<sup>214</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS.pdf

<sup>215</sup> Evidenca 29.b. Raport vjetor per cilesine.pdf

<sup>216</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

<sup>217</sup> Evidenca 44. Tabela 3. punesimi real i studenteve.pdf

duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia Bazë në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësinë dhe Zyrën e Alumni dhe Karrierës organizojnë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve si dhe ruajnë komunikime të shpeshta me ta për mbështetjen e tyre të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim. <sup>218</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kritereve 1-5 të standardit V.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC) në mbështetje dhe nga Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KSSC), janë strukturat përgjegjëse të UniBa që mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Statutin e UniBa <sup>219</sup> konstatohet se studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimarrje në të gjitha organet drejtuese të UniBa. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në Dekanat, në Këshillin/Qeverinë e Studentëve, si dhe janë pjesë e GVB <sup>220</sup> të programeve të studimit. <sup>221</sup>

<sup>218</sup> Evidencë Shtesë 6. Zyra Alumni.pdf

<sup>219</sup> Evidencë 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>220</sup> Evidencë 1.4.f. Urdher Nr. 41, - Per ngritjen e GVB.pdf

<sup>221</sup> Evidencë 27. Politika te perkrahjes dhe mbeshtetjes per studenteve.pdf

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se IAL garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në Senatit Akademik të UniBa, ku çdo Njësi Kryesore përfaqësohet me një student si anëtar. Studentët organizohen edhe në Këshilla Studentorë ku paraqesin problematika në lidhje me programet e studimit, planet mësimore dhe procesin mësimor. Këshillat Studentore janë organe të pavarura të IAL që promovojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese të UniBa<sup>222</sup>. Këshilli i Studentëve zgjidhet çdo dy vjet. Studentët gjithashtu kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjes në Departament një herë në muaj si dhe janë pjesë thelbësore e procesit të vlerësimit që realizohet nga NJZHKC dy herë në vit për procesin mësimorë dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB)<sup>223</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Konstatohet se opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë<sup>224</sup> dy herë në vit me anë të anketimeve dhe pyetësorëve që kanë për qëllim të analizojnë cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në çdo semestër mësimor<sup>225</sup>. Rezultatet e pyetësorëve i përcillen Përgjegjësit të Njesisë Bazë i cili analizon rezultatet e ankimimit dhe diskuton në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Rezultatet e pyetësorëve bëhen pjesë e raportit vjetor të analizës mësimore të Njesisë Bazë<sup>226</sup>. Studentët ftohen nga organet drejtuese për të diskutuar mbi problematikat dhe rekomandime për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe</p>	<p>Rregullorja e UniBa garanton të drejtën e studentit për të dhënë mendim në lidhje me procesin mësimor, stafin akademik dhe infrastrukturën<sup>227</sup>. Pyetësorët semestralë mundësojnë studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërbejnë si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimit nga ana e departamenteve. Bazuar në takimin që GVJ pati me studentët, konstatohet që FSHSTS</p>

<sup>222</sup> Evidencë Shtesë I. Te dhëna për Këshillat Studentore në IAL.pdf

<sup>223</sup> Evidenca 27. Politika të përkrahjes dhe mbështetjes për studentëve.pdf

<sup>224</sup> Evidenca 16.2. Rregulloret e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë (NJZHKSC).pdf

<sup>225</sup> Evidenca 16.4. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët.pdf

<sup>226</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem I.pdf; Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem II.pdf

<sup>227</sup> Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, datë 28/03/2023.pdf



<p>reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>Stafi akademik i jep studentëve rezultatin e provimit brenda 5 ditëve nga realizimi i provimit dhe sqaron studentët në lidhje me vlerësimit. Pas ballafaqimit me komisionin e provimit të lëndës studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin duke ndjekur hapat konform Nenit 88, Rregullore UniBa<sup>228</sup>. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se një procedurë e tillë nuk reflektohet në Rregulloren e MPMTIK.</p> <p><i>Rekomandohet detajimi i Rregullores së MPMTIK me të gjitha nenet e domosdoshme bazuar në Statutin e UniBa dhe rregulloret e tjera institucionale që kanë lidhje me të.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit V.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se studentët me përfaqësuesit e tyre angazhohen në organet vendimmarrëse të UniBa si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, KSSC, Këshillat Studentorë, GVB etj. Opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nëpërmjet anketimeve dhe pyetsorëve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj. Rekomandohet detajimi i Rregullores së MPMTIK me të gjitha nenet e domosdoshme bazuar në Statutin e UniBa dhe rregulloret e tjera institucionale që kanë lidhje me të.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>228</sup> Evidenca 15. Procedurat e ankimimit Neni 89- 90, RREGULLORE E UNIBA.pdf



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa vë në shërbim të informimit të studentëve Zyrën e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyrën e Dekanit të Studentëve, Zyrën e Alumni dhe Karrierës dhe Departamentin përmes Koordinatorit të tij<sup>229</sup>.</p> <p>Informimi i studentëve sigurohet përmes përdorimit të formave si më poshtë vijon<sup>230</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Takimet informuese;</li> <li>- Faqja zyrtare web e UniBa dhe rejtet sociale Facebook dhe Instagram;</li> <li>- Organet drejtuese dhe Stafit akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet;</li> <li>- Sekretaria Mësimore e cila informon studentët për tarifën e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm;</li> <li>- Broshura, Guida e Studentit, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të ngritura të saj të cilat funksionojnë bazuar në Organigramën e UniBa<sup>231</sup>. Ndër strukturat kryesore bazë mbështetëse për studentët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjësi i Departamentit</li> <li>- Koordinator i Programit të studimit<sup>232</sup></li> <li>- Dekani i Studenteve<sup>233</sup></li> <li>- Zyra e Alumni dhe Karrierës</li> <li>- Sekretaria Mësimore</li> </ul>

<sup>229</sup> Evidenca 28. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve- shtylla II.pdf (Neni 12)

<sup>230</sup> RVB TIK.pdf

<sup>231</sup> Evidenca 9- Organigrama e UniBa.pdf

<sup>232</sup> Evidenca 47. Urdher i Brendshëm Nr.29 datë 14.10.2022 Për emërim në detyrë të koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional.pdf

<sup>233</sup> Evidenca 6- Plani i punës i aktiviteteve të parashikuara për vitin akademik 2023-2024.pdf

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Finances</li> <li>- Faqet web [<a href="https://umb.edu.al/">https://umb.edu.al/</a>] dhe rrjetet sociale</li> <li>- Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet</li> </ul> <p>Nga ana institucionale studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit në Sekretarinë Mësimore dhe në Departament<sup>234</sup>. Zyra e Alumni dhe Karrierës drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë<sup>235</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Zyra e Alumni dhe Karrierës<sup>217</sup> realizon këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në UniBa dhe organizon dhe koordinon aktivitete për studentë të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, etj. UniBa mbështet zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale me anë të bashkëpunimeve me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet që mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara<sup>236</sup>. UniBa përdor Klubin e Karrierës<sup>237</sup> në funksion të organizimit të studentëve në aktivitete lidhur me zhvillimin e karrierës me fokus zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për t'u bërë konkures në tregun e punës si dhe strukturat e BTTC dhe AM-Barleti Human Capital për të lehtësuar angazhimin dhe ndërveprimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm<sup>216</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,</p>	<p>Zyra e Alumni dhe Karrierës ka përgjegjësi përditësimin e bazës së të dhënave për punësimin e të diplomuarve të UniBa<sup>216</sup>. Ajo organizon takime të rregullta me Alumni ndër vite dhe këshillon</p>

<sup>234</sup> Evidenca 28. Rregullore e funksionimit te zyrave ne sherbim te studenteve- shtylla II.pdf

<sup>235</sup> Evidenc Shtes 6. Zyra Alumni.pdf

<sup>236</sup> 34. Marrveshje Bashkpunimi.pdf; 34.1. Marrveshje Bashkpunimi.pdf

<sup>237</sup> Evidenca 20.2 Strategji e klubeve studentore 2020-2025.pdf; Evidenca 20.3. Manual i Klubeve Studentore.pdf

përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	dhe orienton studentët e UniBa që diplomohen për mundësi punësimi në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si edhe mundësitë e punësimit në tregje rajonale e më gjërë <sup>217</sup> . Me anë të një pyetëso <sup>238</sup> në Google Forms pasuron bazën e të dhënave dhe gjeneron raporte në funksion të marrjes së vendimeve në lidhje me përmirësime apo ndryshime të mundshme që mund t'i bëhen programit të studimit.
--	--

<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit V.6, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Zyra e Alumni dhe Karrierës në UniBa, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Faqja ueb dhe rrjetet sociale, ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet, Përgjegjësi i Departmentit, Koordinator i Departamentit dhe pedagogët janë disa nga njësitë e posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>
--------------------	--

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<sup>238</sup> [https://docs.google.com/forms/d/1ruA3zdmClqCAmsELYYiIKOFvb2a8rMHv\\_0TppPI00A/edit](https://docs.google.com/forms/d/1ruA3zdmClqCAmsELYYiIKOFvb2a8rMHv_0TppPI00A/edit)

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UniBa në nivel institucional ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2023<sup>239</sup> si dhe Udhëzues për Mësimdhënien dhe të Nxënët në Shkollën e Lartë<sup>240</sup> me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, përmirësimin e shërbimeve të ofruara, rritjen e bashkëpunimit në komunitet dhe aplikimin e standardeve të larta<sup>241</sup> shoqëruar me një sërë udhëzuesish dhe manuale me metoda të ndryshme inovative në fuksion të mësimdhënies, si: manuali i mësimdhënies online, guidë instruktive e mësimi online<sup>242</sup>, udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa<sup>243</sup>, guidë për plotësimin e paketës së praktikës<sup>244</sup>, manual <i>Portali Studentor</i><sup>245</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Pranë UniBa funksionojnë Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancës si struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese të standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit<sup>246</sup>. Kto njësi ndjekin përmirësimin e cilësisë duke shërbyer si një garanci e shtuar për sigurimin e cilësisë sipas Manualit të Cilësisë<sup>247</sup> të propozuar nga NJZHKC dhe të miratuar në Senatin Akademik të UniBa. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorit të studentit i cili vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie<sup>248</sup></li> <li>- Raportet e hartuara nga Zyra e Vlerësimit të Performancës<sup>249</sup></li> <li>- Analizës vjetore<sup>250</sup> për mësimdhënien të përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit në fund të vitit akademik;</li> </ul>

<sup>239</sup> Evidenca 10 Strategjia e zhvillimit institucional UniBa 2020-2030.pdf

<sup>240</sup> Evidenc Shtes 3. Udhëzues per Mesimdhënien.pdf

<sup>241</sup> Evidenca 59 Politikat per te mesuarit, mesimdhënie dhe cilesine ne mesimdhënien.pdf

<sup>242</sup> Evidenca 38.g Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët.pdf

<sup>243</sup> Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.pdf

<sup>244</sup> Evidenca B.1 Guidë instruktive e student per plotesim paketen e praktikës.pdf

<sup>245</sup> Evidenc Shtese 10. (46.)Portali Studentor UMB Sistemi elektronik Menaxh Aktiv.pdf

<sup>246</sup> Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.pdf

<sup>247</sup> Evidenca 15. Manual i Cilësisë.pdf

<sup>248</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit te studentit 22-23, sem I.pdf; Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit te studentit 22-23, sem II.pdf

<sup>249</sup> Evidenca 29.b. Raport vjetor per cilesine.pdf; Evidenca 52. Miratimi i raportit vjetor per vitin akademik 2022-2023.pdf

<sup>250</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHPETP 2022-2023.pdf

	Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara gjykohet për nevojën për përmirësim të proceseve akademike dhe administrative.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimimeve sanksionohet në rregulloren e institucionit <sup>251</sup> dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, Njësie Kryesore dhe Njësie Bazë. Studentët janë të përfshirë në disa prej strukturave vendimarrëse të UniBa. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve <sup>252</sup> . Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Mendimi i tyre degjohet edhe nga staf i akademik <sup>253</sup> . Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit në lidhje me temat e trajtuara dhe nëse ka nevojë për përmirësime.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJZHKC sipas rregullores së funksionimit të tij parashikon takime periodike me NJSBC-të e fakulteteve, me studentët, stafin akademik dhe jo-akademik me qëllim monitorimin e punës dhe të problematikave të ndryshme. Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve që zhvillohen çdo fund semestri i përcillen departamentit dhe në mënyrë konfidenciale stafit të tij. Raporti diskutohet në mbledhje departamenti me të gjithë anëtarët. Në rregulloren e NJZHKC, Neni 10 <sup>254</sup> theksohet që të dhënat e vlerësimeve bëhen të njohura për stafin dhe studentët duke u publikuar në faqen zyrtare të UniBa, por konstatohet që në Raportin e publikuar në <a href="http://umb.edu.al/dossier-uniba.html">umb.edu.al/dossier-uniba.html</a> mungon një analizë e pyetësoreve.  <i>Rekomandohet që IAL të përfshijë në Raportin Vjetor që bën publik në faqen e tij zyrtare web përmbledhjen e analizës së pyetësorëve semestralë ose vjetorë.</i>

<sup>251</sup> Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, date 28032023.pdf

<sup>252</sup> Evidenca 16.4. Formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentet.pdf

<sup>253</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem I.pdf; Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem II.pdf

<sup>254</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKSC).pdf

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në përmbushje të misionit të tij UniBa promovon shembuj të praktikave më të mira<sup>255</sup>, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja<sup>256</sup>.</p> <p>UniBa ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për stafin akademik. Personeli akademik ka qenë pjesë e shkëmbimeve të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve, numri i stafit akademik që është angazhuar në kuadër të projekteve të financuara nga BE (ERASMUS+) është tre (3)<sup>257</sup>.</p> <p>UniBa tregon që mbështet financiarisht, tërthorazi, pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore, projekte kërkimore duke nxitur kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Gjatë vitit akademik 2022-2023, stafi akademik i DSHETP, sipas Analizës Mësimore Shkencore<sup>258</sup> ka publikuar pesë (5) artikuj shkencorë në një buletin dhe në një botim shkencor të UniBa dhe pesë (5) referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: Pyetësorit të studentit i cili vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; Raportet e hartuara nga Zyra e Vlerësimit të Performancës si dhe Analizës Vjetore për mësimdhënien të përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit në fund të vitit akademik; Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara gjykohet për nevojën për përmirësim të proceseve akademike dhe administrative. UniBa mbështet pjesëmarrjen në projekte të stafit akademik. <u>Rekomandohet që IAL të përfshijë në Raportin Vjetor që bën publik në faqen e tij zyrtare web përmbledhjen e analizës së pyetësorëve semestralë ose vjetorë.</u></i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

<sup>255</sup> 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf

<sup>256</sup> Evidenca 59 Politikat per te mesuarit, mesimdhënie dhe cilësi ne mesimdhënie.pdf

<sup>257</sup> Evidenca 13b.Shkëmbimet Erasmus+.pdf

<sup>258</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa ka si struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionin e Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë.</li> <li>- Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë.</li> </ul> <p>Të dy këto struktura kanë aktet e tyre rregullatore si: Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë<sup>259</sup> dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë<sup>260</sup>. Organizimi dhe funksionet e tyre janë të parashikuara edhe në Statutin<sup>261</sup> e institucionit, Rregulloren e UniBa-s<sup>262</sup>. Gjithashtu, në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës<sup>263</sup>, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s, por dhe vlerësimin e procesit akademik, kërkimor, sektorit të çështjeve studentore, vlerësimin e marrëdhënieve me komunitetin, vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se NJZHKC është strukturë e pavarur në nivel institucioni që ka si qëllim monitorimin, vlerësimin, zhvillimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së UniBa. Komisioni për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë mbështet NJZHKC për të përmbushur funksionet e saj lidhur me plotësimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. Këto njësi në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Vlerësimit të Performancës , Zyrën e Alumni</p>

<sup>259</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf

<sup>260</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKSC).pdf

<sup>261</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>262</sup> Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim te Senatit Akademik Nr. 7, date 28032023.pdf

<sup>263</sup> 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.pdf

<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dhe Karrierës dhe Dekanin e studentëve luajnë një rol thelbësor në përmbushjen e objektivave që ka hartuar UniBa në dokumentin e Startegjisë së Zhvillimit Institucional 2020-2023<sup>264</sup> në lidhje me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike duke përqëndruar vëmendjen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punësimi i të diplomuarve</li> <li>- Përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i Bibliotekës</li> <li>- Mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA</li> <li>- Ndërkombëtarizimi etj.</li> </ul> <p>Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, konstatohet se, GVB<sup>265</sup> është ngritur në përputhje me Statutin e UniBa në bashkëpunim më NJZHKC dhe ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 3. Institucioni</b> përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” akreditohet periodikisht sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 60, datë 16.12.2021<sup>266</sup>, me kohëzgjatjen prej 5 (pesë) vite. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është 15.12.2026.</p> <p>Programi i studimit MPMTIK është hapur me Urdhër Nr. 506, datë 06.09.2022 “Mbi hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”<sup>267</sup> në Universitetin Barleti. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit MPMTIK, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. Universiteti “Barleti” ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që përbëhet nga: formulari i vlerësimit të studentëve për lëndën<sup>268</sup> në formën e pyetësorëve anonimë, nga analiza e të cilëve hartohet një raport, formular mbi transparencën e vlerësimit<sup>269</sup>, formulari i</p>

<sup>264</sup> Evidenca 10 Strategjia e zhvillimit institucional UniBa 2020-2030.pdf

<sup>265</sup> Evidenca 1.4.f. Urdher Nr. 41. - Per ngritjen e GVB.pdf

<sup>266</sup> Për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Barleti

<sup>267</sup> Për hapjen e programit të studimit cikli i Dytë Master Profesional Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikim, Universiteti Barleti

<sup>268</sup> Evidenca 16.4. Formular i vlerësimit te lendes dhe pedagogut nga studentet.pdf

<sup>269</sup> Evidenca 16.6. Formulari për transparencë të vlerësimit.pdf



	vlerësimin kolegë me kolegë <sup>270</sup> , formular për raportimin e punës semestrale të pedagogut. <sup>271</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	NJZHKC mbështetur nga KSSC, ka në kompetencat e tij hartimin e raportit vjetor të sigurimit të cilësisë <sup>272</sup> . Raporti përmban informacion të diskutuar paraprakisht me të gjithë anëtarët e departamenteve, përfaqësuesit e studentëve, të ekspertëve të jashtëm, sekretarisë mësimore dhe Dekanit <sup>273</sup> . UniBa bazuar në instrumentat e brendshëm të saj për sigurimin e cilësisë, përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga NJZHKC, konstatohet se UniBa ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standardeve të cilësisë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit VI.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UniBa ka ngritur struktura institucionale si NJZHKC, KSSC, GVB të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

<sup>270</sup> Evidenca 16.5. Formulari Peer Evaluation of Teaching.pdf

<sup>271</sup> Evidenca 16.3. Formular - Raportim i Punes Semestrale te pedagogut.pdf

<sup>272</sup> Evidenca 29.b. Raport vjetor per cilesine.pdf; Evidenca 52. Miratimi i raportit vjetor per vitin akademik 2022-2023.pdf

<sup>273</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit MPMTIK. NJZHKC kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit<sup>274</sup>. Zyra e Alumnit dhe Karrierës harton pyetësorë që targetojnë kompanitë dhe alumni dhe ka për qëllim të paraqesë statistikën në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, numrin e studentëve të çregjistruar, numrin e studentëve të diplomuar, personelin akademik dhe administrativ, numrin e studentëve që përfitojnë bursë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit MPMTIK kryhet në mënyrë periodike, në raportet vjetore të DSHETP,<sup>275</sup> që është përgjegjës për këtë program studimi. Ai analizon ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse.<sup>276</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se raportet e vlerësimit të miratuara, përcillen për diskutim në të gjitha strukturat e IAL deri në nivel Njësie Bazë<sup>256,257</sup>. Ky proces finalizohet me një sërë masash në funksion të përmirësimit të programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe</p>

<sup>274</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem I.pdf; Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem II.pdf

<sup>275</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

<sup>276</sup> Evidenca 29.b. Raport vjetor për cilësim.pdf; Evidenca 52. Miratimi i raportit vjetor për vitin akademik 2022-2023.pdf



<p>të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>mësimnxënies, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.<sup>258</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se UniBa përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e programit të studimit MPMTIK. Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2030 UniBa synon të krijojë modelin e universitetit aplikativ, i cili e zhvillon aktivitetin mbështetur në pesë shtylla kryesore të cilat janë: Shtylla Akademike, Shtylla e Studentit në Qendër, Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit, Shtylla Korporative dhe Administrative dhe Shtylla Sipërmarrëse.<sup>277</sup></p> <p>Në planin e veprimit, për përmbushjen e objektivave të Strategjisë Institucionale<sup>278</sup> janë të angazhuar të gjithë aktorët e IAL, si Bordi i të Besuarve, Senati Akademik, Asambleja e Personelit Akademik, Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Vlerësimit të Performancës, Bordi i Administrimit., Përgjegjësit e Departamenteve dhe strukturat e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës<sup>279</sup> kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit i cili mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat vjetore mësimore shkencore të Departamentit<sup>280</sup>. Në vazhdim të gjitha strukturat e tjera marrin pjesë në hartimin e masave dhe përmirësimin cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies<sup>281</sup>. Institucioni, në kuadër të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportimi nga pedagogu për punën semestrale<sup>282</sup></li> </ul>

<sup>277</sup> Evidenca 10 Strategjia e zhvillimit institucional UniBa 2020-2030.pdf


<sup>278</sup> Evidenca 10 .1 - Strategjia e nderkombetarizimit UniBa.pdf; Evidenca 20.2 Strategji e klubeve studentore 2020-2025.pdf; Evidenca 32.f. Strategjia dhe plani i veprimit per zhvillim e departamentit 2022-2025.pdf; Evidenca 41. Strategjia e marketingut.pdf

<sup>279</sup> Evidenca 16.6. Formulari për transparencë të vlerësimit.pdf

<sup>280</sup> Evidenca 35. Analiza Vjetore e DSHETP 2022-2023.pdf

<sup>281</sup> Evidenca 59 Politikat per te mesuarit, mesimdhenie dhe cilesine ne mesimdhenie.pdf

<sup>282</sup> Evidenca 16.3. Formular - Raportim i Punes Semestrale te pedagogut.pdf



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësim i studentëve në fund të çdo semestri nga NJZHKC<sup>283</sup></li> <li>- Vëzhgime në auditor<sup>284</sup></li> <li>- Rezultatet e provimeve</li> <li>- Miratimi i tezës së provimit nga drejtuesi/a i/e departamentit</li> <li>- Mbledhje mujore në department për ecurinë e procesit mësimor</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>NJZHKC mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit si<sup>285</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- organizon pyetësore drejtuar studentëve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe pedagogut përkatës dhe vlefshmërinë e tij tek Alumni<sup>286</sup></li> <li>- mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë në rajon në lidhje me Alumni-t e UniBa.</li> <li>- organizon workshope/panaire pune ku mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë për mbështetjen e praktikave profesionale.</li> <li>- Sondazhe të Qeverisë studentore<sup>287</sup></li> </ul> <p>Gjithashtu, institucioni vlerëson edhe angazhimin administrativ dhe kërkimor shkencor të stafit akademik dhe të studentëve.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit VI.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Vlerësohet pozitivisht puna e</i></p>

<sup>283</sup> Evidenca 16.4. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentet.pdf

<sup>284</sup> Evidenca 16.5. Formulari Peer Evaluation of Teaching.pdf

<sup>285</sup> Evidenca 15. Manual i Cilësisë.pdf

<sup>286</sup> Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem I.pdf; Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 22-23, sem II.pdf

<sup>287</sup> <https://umb.edu.al/news5488.html>

	<p><i>NJZHKC në përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve të bëra.</i></p> <p><i>Sugjerohet që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e një plani masash veprimi për adresimin e problematikave dhe ndjekjen e shkallës së përbushjes së tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti <sup>288</sup> dhe Rregullorja e UniBa <sup>289</sup> dhe Rregullore e NJZHKC <sup>290</sup> dhe KSSC <sup>291</sup> ) dhe vizitat në institucion konstatohet se në institucion funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional (Senati Akademik, NJZHKC, KSSC, Zyra e Vlerësimit të Performancës me Zyrën e Alumni dhe Karrierës), në nivel Fakulteti (Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, Koordinatorët e Programeve të studimit <sup>292</sup> , Përfaqësuesit e Bizneseve) dhe studentët <sup>293</sup> . Konstatohet se institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm <sup>294</sup> të aktorëve të brendshëm, stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion <sup>295</sup> dhe nga takimet e kryera në institucion, konstatohet se strukturat e brendshme

<sup>288</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf

<sup>289</sup> Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, datë 28032023.pdf

<sup>290</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKSC).pdf

<sup>291</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf

<sup>292</sup> Evidenca 47. Urdher i Brendshem Nr.29 datë 14.10.2022 Për emërim në detyrë të koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional.pdf

<sup>293</sup> Evidenca 28. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studenteve- shtylla II.pdf

<sup>294</sup> Evidenca 48. Plani i punës i NjZHKC.pdf

<sup>295</sup> RVB TIK.pdf

<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion kanë detyra të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të brendshme. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë<sup>296</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- NJZHKC</li> <li>- KSSC</li> <li>- Zyra e Vlerësimit të Performancës</li> <li>- Zyrën e Alumni dhe Karrierës</li> </ul> <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi</li> <li>- Koordinatorët e Programeve të Studimit</li> </ul> <p>Studentët dhe Ekspertë të jashtëm janë gjithashtu palë të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se stafi akademik dhe administrativ bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me NJZHKC dhe KSSC për sigurimin dhe vlerësimin e brendshëm institucional. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit MPMTIK janë përfshirë staf akademik, ekspert të jashtëm dhe studentë.<sup>297</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se në ngritjen e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe gradë apo kualifikimi akademik<sup>279</sup>. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve<sup>298</sup>. Ky proces përfshin procesin e vlerësimit të pedagogut nga eprorët</p>

<sup>296</sup> Evidenca 15. Manual i Cilësisë.pdf

<sup>297</sup> Evidenca 1.4.f. Urdher Nr. 41, - Per ngritjen e GVB.pdf

<sup>298</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 33. Kodi i Etikes.pdf

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	dhe nga studentët. Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në rregulloren institucionale të sigurimit të cilësisë. <sup>278,299</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Konstatohet se institucioni që në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, si pjesë integruese të tij, përfshin edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm<sup>300</sup>. Forma të tjera bashkëpunimi me aktorë të jashtëm të tregut për të marrë ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i workshopeve dhe praktikave mësimore pranë kompanive partnere<sup>301</sup></li> <li>- Analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me ato të ofruar në IAL të ngjashme brenda e jashtë vendit;</li> <li>- Mbështetja e Mobiliteteve të studentëve nëpërmjet projekteve Erasmus+<sup>302</sup></li> </ul> <p>Konstatohet se Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit MPMTIK realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit dhe nevojave për rishikimin e tij.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se UniBa/FSHSTS përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

### Standardi VI.5

<sup>299</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise (NJZHKSC).pdf; Evidenca 17. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf

<sup>300</sup> 34. Marrveshje Bashkpunimi.pdf; 34.1. Marrveshje Bashkpunimi.pdf

<sup>301</sup> Evidenca 32.b. Lista e Konferencave dhe workshopeve.pdf

<sup>302</sup> Evidenca 32. c. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve.pdf

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Konstatohet se dokumentacioni (Statuti i UniBa dhe Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, Rregullorja e UniBa dhe e FSHSTS) në të cilin është përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë vënë në dispozicion të GVJ, dhe janë të publike në faqen web institucionale<sup>303304</sup>. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent dhe u komunikohet individualisht studentëve dhe të gjithë aktorëve të IAL-së.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparencja dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm<sup>305</sup> dhe i publikon në faqen zyrtare<sup>306</sup> duke respektuar lirinë akademike, ruan etikën<sup>307</sup> akademike dhe respekton legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha të dhënat në UniBa përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar politikat institucionale të privatësisë së të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>NJZHKC në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.</p>

<sup>303</sup> <https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html>

<sup>304</sup> <https://umb.edu.al/dossier-uniba.html>

<sup>305</sup> <https://umb.edu.al/upload/dossier/Raport-per-Vleresimin-e-Cilesine-ne-UniBa-22-23-updt.pdf>

<sup>306</sup> <https://umb.edu.al/dossier-uniba.html>

<sup>307</sup> Evidenca 54 Rregullore e Keshillit të Etikes.pdf; Evidenca 33. Kodi i Etikes.pdf



<p>mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Për përmirësimin e planit mësimor, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës, departamenti propozon ndryshimet e nevojshme në programin e studimit apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuar për përmirësim. Në rast se nga njësia bazë, konstatohet nevoja për ndryshime në kredite në masën mbi 20% të përmbajtjes së programit të studimit të akredituar, ndryshimet e hartuara nga Departamenti shqyrtohen në Dekanat, miratohen në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Ndërsa, ndryshimet deri në masën 20%, IAL mund t'i reflektojë në diplomën e lëshuar me miratim nga Senati Akademik i UniBa<sup>308</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton angazhim nga ana e UniBa në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Institucioni siguron efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit përmes rezultateve të marra nga vlerësimi i brendshëm, vlerësimi i jashtëm dhe nga vetë procesi i akreditimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UniBa mbështet të gjitha organet e brendshme në trajnime me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni<sup>309</sup>. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, Koordinatorin<sup>310</sup> i programit të studimit ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe informon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesin e Njesisë Kryesore / Bazë në lidhje me ecurinë e programit të studimit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se institucioni paraqet kulturë të brendshme të cilësisë mbi politikën, proceset dhe veprimtaritë për</i></p>

<sup>308</sup> Evidenca 1.1 - Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, datë 28/03/2023.pdf

<sup>309</sup> <https://umb.edu.al/news4901.html>; <https://umb.edu.al/news5125.html>; <https://umb.edu.al/news5030.html>

<sup>310</sup> Evidenca 47. Urdhër i Brendshëm Nr.29 datë 14.10.2022 Për emërim në detyrë të koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe trajnimit Profesional.pdf

	<i>Sigurimin e Brendshëm, të cilat janë të sanksionuara në rregulloret dhe strategjitë e institucionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Mësuesi në Teknologji Informatik dhe Komunikim" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Barleti"

#### Pikat e forta dhe afirmime

1. Ky program studimi ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë, që zhvillohet në dy vite studimi me 120 kredite, dhe i mundëson studentëve që të punësohen direkt në tregun e punës.
2. Departamenti që mbulon zhvillimin e programit të studimit ka përvojën, kapacitete akademike, si edhe burimet e duhura për administrimin me sukses të gjithë programit.
3. Format e vlerësimit dhe monitorimit që ofron njësia përgjegjëse mbështetin në mënyrë efektive përmirësimin e cilësisë së programit.
4. Bashkëpunimi dhe klima pozitive e krijuar mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik si edhe studentëve mbështet plotësisht përmirësimin e cilësisë së programit.
5. Programi përfiton nga një infrastrukturë e plotë duke u ofruar studentëve akses në salla leksionesh, seminaresh, laborator, bibliotekë dhe objekte të tjera thelbësore për një përvojë efektive të të mësuarit.

#### Pika të dobta

1. Standardi II.4, Kriteri 5. Rifreskim i literaturës në funksion të programit të studimit. Personeli akademik luan një rol kyç në këtë proces duke integruar literaturë të re që përputhet me objektivat e programit të studimit.
2. Standardi II.6, Kriteri 1 dhe 3. Shtimi i vëmëndjes ndaj kërkimit shkencor. Programi duhet të nxisë një mjedis kërkimi intensiv tek studentët e MPMTIK duke i inkurajuar të kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushën e mësuesisë dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në arsim.
3. Standardi III.4, Kriteri 4. Rritja e mobilitetit të studentëve të programit të studimit. Duke inkurajuar mobilitetin e studentëve, institucionet e arsimit të lartë synojnë të ofrojnë një përvojë arsimore të larmishme dhe të pasur me ekspozim ndaj kulturave dhe perspektivave të ndryshme arsimore.

#### Rekomandime

1. Rekomandohet modifikim i programit të studimit në mënyrë që kreditet e lëndëve ndërdisiplinore/integruese të jenë midis 20-30 përqind të krediteve totale për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.
2. Rekomandohet që në kurrikulën e programit të studimit MPMTIK të krijohet mundësia e grup-lëndëve me zgjedhje dhe orëve laboratorike.

3. Rekomandohet që syllabuset të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me literaturë bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit dhe të përfshihet në fondin e Bibliotekës.
4. Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit MPMTIK të përcaktohen objektiva që lidhen specifikisht me kërkimin shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit si dhe detajimi i saj me të gjitha nenet e domosdoshme bazuar në Statutin e UniBa dhe rregulloret e tjera institucionale që kanë lidhje me të.
5. Rekomandohet që në rregulloren e programit të studimit MPMTIK, të merret në konsideratë përmbyllja e studimeve edhe në trajtën e punimit të një teme diplome.
6. Rekomandohet krijim i mundësisë së konferencave periodike studentore me qëllim nxitjen për përfshirje dhe angazhim në studime dhe aktivitete kërkimore.
7. Rekomandohet që institucioni të rrisë mundësi studentëve të MPMTIK të përfshihen në shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare (mobiliteteve) nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit.
8. Rekomandohet që institucioni të mbështet financiarisht stafin akademik efektiv të përfshirë në programin e studimit për publikimin e punimeve kërkimore në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të rankuara me faktor impakti.
9. Rekomandohet që të rishikohet nota mesatare e vendosur për të realizuar tezë kërkimi, me qëllim mbështetjen e një numri më të lartë studentësh për të zhvilluar kompetencën kërkimore shkencore.
10. Rekomandohet që të konsiderohen në paketën e praktikës profesionale tregues/indikator që mbështesin përmbushjen e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit dhe profilit lëndor për të cilin studenti do të diplomohet. Gjithashtu, të hartohet syllabusi dhe të shpërndahet ngarkesa mësimore e kësaj lënde.
11. Rekomandohet angazhimi i personelit ndihmës akademik - laborant pranë FSHSTS me qëllim asistimin e orëve që zhvillohen në ambientin e laboratorit.
12. Rekomandohet hartimi i një Fondi Pyetje për Provën Finale bazuar në Fondin e Pyetjeve të Provimit të Liçensimit dhe të bëhen ndryshimet e duhura në rregulloret përkatëse në lidhje me përcaktimin se cila do të jetë forma e realizimit të Provës Finale në përmbyllje të studimeve në programin e studimit MPMTIK.
13. Rekomandohet që literatura bazë në lëndën “Didaktikë e TIK” të ketë orientim didaktik me qëllim plotësimin e objektivit kryesor që ka vetë programi i studimit MPMTIK.
14. Rekomandohet që kriteret hyrëse në programin e studimit MPMTIK të detajohen me përcaktimin e fushave të ciklit të parë të studimit që studenti duhet të ketë pjesë të formimit të tij për t’u bërë pjesë e MPMTIK si dhe hartimin e kuotave të veçanta të pranimit për mbështetjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave, shtresave të marginalizuara dhe të trojeve.
15. Rekomandohet që IAL të përfshijë në Raportin Vjetor që bën publik në faqen e tij zyrtare web përmbledhjen e analizës së pyetësorëve semestralë ose vjetorë.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master of "Teachers of Information and Communication Technologies" provided by the Higher Education Institution "Barleti"

#### Strengths and affirmations


1. This programme has a satisfactory ratio of theory to practice, is completed in two years with 120 credits and allows students to be directly employed in the labour market.
2. The forms of evaluation and monitoring foreseen by the responsible unit effectively support the improvement of the quality of the programme.
3. The cooperation and positive climate created between the dean, the head of the department, the academic staff as well as the students fully supports the improvement of the quality of the program.
4. The programme benefits from a comprehensive infrastructure providing students with access to lecture halls, seminars, laboratory, library and other facilities essential for an effective learning experience.

#### Weaknesses

1. Standard II.4, Criteria 5. Updating the literature in relation to the programme. Academic staff play a key role in this process by integrating new literature that meets the objectives of the programme.
2. Standard II.6, Criteria 1 and 3. Increased attention to research. The programme should foster an intensive research environment among MPMTIK students, encouraging them to contribute to the advancement of knowledge in the field of teaching and information and communication technology in education.
3. Standard III.4, Criteria 4. Increase the mobility of students in the programme. By promoting student mobility, higher education institutions aim to provide a diverse and rich educational experience with exposure to different cultures and educational perspectives.

#### Recommendation

1. The study program should be modified to ensure that the credits of interdisciplinary/integrative courses constitute between 20-30 percent of the total credits to guarantee the achievement of the formative objectives of the study program.
2. In the curriculum of the MPMTIK study program, it is recommended to create the possibility of a group of optional courses and laboratory hours.
3. The syllabus should be constantly up to date with Albanian and foreign literature of recent years.
4. In line with the main objectives of the institution, it is recommended that the regulations of the MPMTIK programme should define objectives specifically related to scientific research and its specification with all necessary articles based on the Statute of UniBa and other institutional regulations related to.



5. It is recommended that the regulations of the MPMTIK study programme consider the possibility of completing the study in the form of a diploma thesis.
6. It is recommended that the possibility of regular student conferences should be created in order to promote inclusion and involvement in the study and research activities.
7. The institution should increase opportunities for MPMTIK students to be involved in the exchange of international experiences (mobilities) through cooperation agreements.
8. The institution must financially support the effective academic staff involved in the study program for the publication of research papers in national and international scientific journals, ranked by impact factor.
9. It is recommended that the average mark set for the completion of the research dissertation should be reviewed in order to support a greater number of students in the development of their skills in scientific research.
10. Indicators that support the fulfilment of the professional standards of the teacher's general education and the subject profile for which the student is graduating are recommended to be included in the professional practice package. The design of the professional practice curriculum and the distribution of the teaching load of the subject should also be considered.
11. It is recommended that an Academic Staff Assistant - FSHSTS Laboratory Assistant is employed to assist with working hours in the laboratory environment.
12. It is recommended to design a fund of questions for the final examination on the basis of the fund of questions for the licensing examination and to make the appropriate changes in the relevant regulations regarding what will be the form of the final examination at the conclusion of the study programme MPMTIK.
13. In order to meet the main objective of the MPMTIK programme, it is recommended that the basic literature in the subject "ICT Didactics" has a didactic orientation.
14. The MPMTIC study program should outline detailed introductory criteria, identifying the initial study areas within the first cycle of study necessary for students to qualify for inclusion in the MPMTIC program. Additionally, it should incorporate specific admission quotas to support candidates with special abilities, minorities, marginalized populations, and individuals from rural areas.
15. It is recommended that the HEI includes in the annual report, which it publishes on its official website, a summary of the analysis of semester or annual student questionnaires.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Teknologji Informati dhe Komunikimi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të**

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

